



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

# **RAPORT VJETOR** FINANCAT PUBLIKE VENDORE **2021**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

# Raport Vjetor

## Financat Publike Vendore

Maj 2022

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

**FINANCATLOKALE** | Forcimi i Menaxhimit  
**LOCALFINANCES** | të Financave Publike  
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO**

# Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive.....	11
Raporti i treguesve fiskalë vendorë 2021.....	17
Menaxhimi Financiar Publik në nivel vendor dhe Autonomia Fiskale Vendore gjatë vitit 2021.....	20
Treguesit fiskalë të pushtetit vendor gjatë vitit 2021.....	39
Të ardhurat e pushtetit vendor.....	42
Shpenzimet e pushtetit vendor.....	58
Detyrimet e prapambetura.....	71
Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas bashkive.....	74
152 Bashkia Belsh.....	74
102 Bashkia Berat.....	76
103 Bashkia Bulqizë.....	78
110 Bashkia Cërrik.....	80
104 Bashkia Delvinë.....	82
105 Bashkia Devoll.....	84
106 Bashkia Dibër.....	86
147 Bashkia Divjakë.....	88
452 Bashkia Dropull.....	90
107 Bashkia Durrës.....	92
109 Bashkia Elbasan.....	94
111 Bashkia Fier.....	96
326 Bashkia Finiq.....	98
155 Bashkia Fushë-Arrëz.....	100
115 Bashkia Gjirokastrë.....	102
114 Bashkia Gramsh.....	104
117 Bashkia Has.....	106
160 Bashkia Himarë.....	108
166 Bashkia Kamëz.....	110
118 Bashkia Kavajë.....	112
154 Bashkia Këlcyrë.....	114
654 Bashkia Klos.....	116

120	Bashkia Kolonjë.....	118
156	Bashkia Konispol.....	120
122	Bashkia Korçë.....	122
123	Bashkia Krujë.....	124
125	Bashkia Kuçovë.....	126
127	Bashkia Kukës.....	128
129	Bashkia Kurbini.....	130
131	Bashkia Lezhë.....	132
116	Bashkia Libohovë.....	134
133	Bashkia Librazhd.....	136
135	Bashkia Lushnjë.....	138
137	Bashkia Malësi e Madhe.....	140
168	Bashkia Maliq.....	142
132	Bashkia Mallakastër.....	144
139	Bashkia Mat.....	146
143	Bashkia Memaliaj.....	148
141	Bashkia Mirditë.....	150
112	Bashkia Patos.....	152
134	Bashkia Peqin.....	154
135	Bashkia Përmet.....	156
136	Bashkia Pogradec.....	158
140	Bashkia Poliçan.....	160
153	Bashkia Prrenjas.....	162
137	Bashkia Pukë.....	164
499	Bashkia Pustec.....	166
119	Bashkia Rrogozhinë.....	168
113	Bashkia Roskovec.....	170
137	Bashkia Sarandë.....	172
159	Bashkia Selenicë.....	174
108	Bashkia Shijak.....	176
141	Bashkia Shkodër.....	178
139	Bashkia Skrapar.....	180
142	Bashkia Tepelenë.....	182
101	Bashkia Tiranë.....	184
145	Bashkia Tropojë.....	186

167	Bashkia Dimal.....	188
157	Bashkia Vau i Dejës.....	190
146	Bashkia Vlorë.....	192
165	Bashkia Vorë.....	194

**Analiza e buxheteve sipas Këshillave të Qarqeve  
në të ardhura dhe shpenzime.....**

		<b>196</b>
042	Këshilli i Qarkut Berat.....	196
046	Këshilli i Qarkut Dibër.....	197
047	Këshilli i Qarkut Durrës.....	198
048	Këshilli i Qarkut Elbasan.....	199
049	Këshilli i Qarkut Fier.....	200
011	Këshilli i Qarkut Gjirokastër.....	201
015	Këshilli i Qarkut Korçë.....	202
018	Këshilli i Qarkut Kukës.....	203
020	Këshilli i Qarkut Lezhë.....	204
033	Këshilli i Qarkut Shkodër.....	205
035	Këshilli i Qarkut Tiranë.....	206
037	Këshilli i Qarkut Vlorë.....	207

## Lista e Grafikëve

Grafiku 1: Të ardhurat e veta ndaj totalit të të ardhurave vendore.....	21
Grafiku 2: Transferta e Pakushtëzuar ndaj të ardhurave të veta vendore.....	23
Grafiku 3: Transferta e Pakushtëzuar sektoriale ndaj Të ardhurave të veta vendore.....	25
Grafiku 4: Shpenzime Personeli ndaj Transfertës së Pakushtëzuar.....	27
Grafiku 5: Shpenzime Kapitale ndaj Transfertës së Pakushtëzuar.....	29
Grafiku 6: Shpenzime Kapitale ndaj të ardhurave të veta vendore.....	31
Grafiku 7: Detyrimet e prapambetura ndaj totalit të të ardhurave vendore.....	33
Grafiku 8: Detyrimet e Prapambetura ndaj planit vjetor të shpenzimeve.....	35
Grafiku 9: Transferta nga buxheti qendror ndaj të ardhurave të veta vendore.....	37
Grafiku 10: Plan/Fakt i të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor gjatë vitit 2021.....	39
Grafiku 11: Realizimi mujor i të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor 2021.....	40
Grafiku 12: Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin 2021 dhe vitin 2015.....	41
Grafiku 13: Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore në vitin 2021 dhe 2020.....	42
Grafiku 14: Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB.....	43
Grafiku 15: Të ardhurat tatimore të pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit.....	44
Grafiku 16: Transferta e pakushtëzuar në vite 2011-2021.....	45
Grafiku 17: Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit në vite.....	46
Grafiku 18: Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite.....	47
Grafiku 19: Pesha e të ardhurave sipas burimeve kryesore.....	48
Grafiku 20: Pesha e të ardhurave të pushtetit vendor sipas burimit në vitin 2021.....	49
Grafiku 21: Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore gjatë vitit 2021.....	50
Grafiku 22: Pesha e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore dhe të ardhurat jotatimore sipas NJVQV-ve gjatë vitit 2021.....	51
Grafiku 23: Norma e ndryshimit të të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore 2021/2020.....	53
Grafiku 24: Realizimi i shpenzimeve të pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit në vite.....	58
Grafiku 25: Realizimi i shpenzimeve të pushtetit vendor në vite dhe në raport me totalin të shpenzimeve publike e PBB.....	59
Grafiku 26: Shpenzimet sipas llogarive ekonomike të pushtetit vendor për vitin 2021-2020.....	60
Grafiku 27: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas kalsifikimit ekonomik 2021-2020.....	61
Grafiku 28: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik për vitet 2021.....	62

Grafiku 29: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas klasifikimit funksional për vitet 2021-2020.....	63
Grafiku 30: Ndryshimi i shpenzimeve në nivel funksioni 2021/2020. ....	64
Grafiku 31: Pesha e shpenzimeve sipas funksioneve të pushtetit vendor gjatë vitit 2021.....	65
Grafiku 32: Ndryshimet e shpenzimeve sipas funksioneve dhe burimit të financimit në vitin 2021/2020.....	66
Grafiku 33: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimit të financimit për vitin 2021-2020.....	67
Grafiku 34: Pesha e shpenzimeve të NJVQV-ve sipas burimit të financimit për vitin 2021-2020.....	68
Grafiku 35: Norma e ndryshimit të shpenzimeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore 2021/2020.....	70
Grafiku 36: Detyrimet sipas kategorive në përqindje, për bashkitë.....	72

## Shkurtime

NJVQV – Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

SIFQ – Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm

TAP –Tatimi mbi të Ardhurat Personale

AFMIS - Albanian Financial Management Information System

# Përmbledhje Ekzekutive

**N**ë kuadër të analizës së Financave Vendore, që Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka zhvilluar mbi ecurinë e treguesve fiskalë por edhe në monitorimin e cilësisë së realizimit të buxhetit vendor e nivelit të shërbimeve publike, është evidentuar jo vetëm një performancë pozitive e pushtetit vendor por edhe nevoja për ndryshime metodologjike që përmirësojnë performancën buxhetore.

Lidhja e fortë ndërmjet pushtetit vendor dhe cilësisë së shërbimeve bazë ndaj qytetarëve është një tregues i rëndësishëm për standardin e jetesës së qytetarëve. Forcimi i kapaciteteve të pushtetit vendor në drejtim të menaxhimit mbi bazën e performancës do të sjellë rritjen e rolit të menaxhimit financiar. Rritja e kapacitetit fiskal të njësisve të vetëqeverisjes vendore pas reformës e cila reflektohet edhe në treguesit e vitit 2021, ka nxitur kërkesën e shoqërisë për përmirësimin e shërbimeve publike. Në këtë kontekst, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vendosur në objektivat e saj strategjike decentralizimin fiskal dhe modernizimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor.

Në raport me treguesit kombëtar të pushtetit vendor për vitin 2021, në këtë analizë janë evidentuar treguesit kryesorë fiskal dhe autonomisë si më poshtë:

- Pushteti vendor ka realizuar të ardhura të veta rreth **29.4 miliard lekë**, ku përfshihen 26.6 miliard lekë të ardhura tatimore dhe 2.8 miliard lekë jotatimore, këto të ardhura **janë realizuar rreth 5.2 miliard lekë ose 21.5% më shumë** se realizimi prej 24.2 miliard lekë i të ardhurave të veta vendore gjatë vitit 2020, dhe the **rreth 3.8 miliard lekë ose 15% më shumë** se viti 2019 para pandemisë.
- Të ardhurat tatimore të pushtetit vendor janë realizuar në masën rreth **103% të planit vjetor 2021, pra rreth 26.6 miliard lekë nga 25.9 miliard lekë** të parashikuara në treguesit fiskalë të konsoliduar.
- Në raport me vitin 2015, si viti para reformës, të ardhurat nga taksat vendore **nga 11.7 miliard kanë arritur në vitin 2021 vlerën e rreth 26.6 miliard lekë** osë e thënë ndryshe një rritje **rreth 127%, ndërkohë** shpenzimet vendore prej **52.5 miliard lekë në vitin 2021**, u rritën me rreth 54.4% në raport me vitin 2015 prej 34 miliard lekë.
- Të ardhurat e pushtetit vendor, në raport me të ardhurat publike janë rritur **nga 5.16% në vitin 2020 në 5.22%** në vitin 2021.
- Pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi e në Produktin e Brendshëm Bruto duke ndryshuar raportin e të ardhurave ndaj PBB-së, **nga 0.82%**

**e PBB-së në vitin 2015 në 1.51 % në vitin 2021, me një rritje prej 0.69% e PBB-së.**

- Transferta e pakushtëzuar **nga 17.2 miliard lekë në vitin 2020** ka arritur në vlerën e rreth **18.4 miliard lekë ose ndryshe me një rritje rreth 7%.**
- Pushteti vendor gjatë vitit 2021, ka realizuar rreth **52.5 miliard lekë shpenzime ose rreth 91% e planit vjetor** të treguesve fiskalë të konsoliduar **prej 57.9 miliard lekë.**
- Në raport me një vit më parë, gjatë vitit 2021 shpenzimet e **pushtetit vendor në raport me PBB, kanë pësuar një rënie të lehtë prej 0.22%.** Ndërkohë, **në raport me shpenzimet publike 510 miliard lekë** të një viti më parë, gjatë vitit 2021 shpenzimet e pushtetit vendor patën **një rënie prej 0.76%.**
- Peshën më të madhe të shpenzimeve gjatë vitit 2021 e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime në rreth **45.9% të totalit të shpenzimeve vendore.**
- Pushteti vendor gjatë vitit 2021 ka realizuar rreth **8,800 lekë të ardhurat** të veta vendore për banor dhe gjithashtu rreth **15,800 lekë shpenzime buxhetore** për banor.
- Në raport me një vit më parë konstatohet që **shpenzimet për investime** kanë një **rënie me rreth 1.7 miliard lekë ose 13.1% më pak krahasuar me vitin 2020.**
- **Shpenzimet e personelit** kanë një rritje të lehtë me pothuajse të njëjtën vlerë sa rënia e **shpenzimeve për investime me rreth 1.7 miliard lekë.** Ndërkohë **shpenzimet operative paraqiten me rritje me 600 milion lekë** krahasuar me shpenzimet e vitit 2020.
- Të ardhurat e veta të pushtetit vendor përfshirë të ardhurat tatimore dhe jotatimore **prej 29.4 miliard lekë,** ndaj të ardhurave totale prej **55.5 miliard lekë** ku përfshihen edhe transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale zënë **rreth 53%.**
- Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj totalit të të ardhurave të pushtetit vendor **vetëm në 6 bashki si: Durrës, Tiranë, Roskovec, Sarandë, Himare dhe Vorë zë mbi 50%.**
- Si tregues i rëndësishëm i autonomisë, rreth 34 bashki kanë një vlerë më të ulët së **mesatarja prej 29%** të të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave. Në rreth 6% të këtij raporti paraqiten bashki të tilla si Memaliaj dhe Pusteci, ndërkohë vlerën më të lartë të këtij raporti e ka bashkia Tiranë dhe Himarë me rreth 82% dhe 74%.
- Në totalin e të ardhurave vendore rreth **33% e zënë të ardhurat nga transfertat e buxhetit qendror, 53% të ardhurat e veta dhe pjesa tjetër 14 % e zënë të ardhurat nga financimi i huaj** dhe burime të tjera,
- **Rreth 27.8%** është raporti i Transfertës së Pakushtëzuar Sektoriale (**8.2 miliard lekë**) mbi të ardhurat e veta të njësisve të vetëqeverisjes vendore prej **29.4 miliard lekë.**
- Gjatë vitit 2021, **shpenzimet e personelit** të pushtetit vendor prej **24.1 miliard lekë zënë rreth 131% të transfertës së pakushtëzuar prej 18.4 miliard lekë** që transferohet nga buxheti qendror.

- **Shpenzime Kapitale (11.2 miliard lekë) gjatë vitit 2021** në raport me transfertën e pakushtëzuar prej **rreth 18.4 miliard lekë**, zënë vetëm **60.8% dhe** në raport me **të ardhurat e veta vendore prej rreth 29.4 miliard lekë**, zënë **vetëm 38%**. Ky raport si pasojë e nivelit të ulët të të ardhurave të veta vendore për disa bashki si Bulqiza, Memaliaj, Tropoja etj, është mbi 100%. Ndërkohë, bashki me kapacitet të lartë fiskal si: Tirana, Durrësi, Fieri, Korça etj, kanë një **nivel nën 50% të këtij raporti**.
- Nga ana tjetër stoku i **detyrimeve të prapambetura zë rreth 11.4% të totalit të planit të buxhetit** të njësisve të vetëqeverisjes vendore prej **57.9 miliard lekë dhe rreth 12.5% të totalit të realizimit të buxhetit vendor prej 52.5 miliard lekë**.
- **Detyrimet e prapambetura(6.6 miliard lekë)** zënë rreth 22.4% në raport me totalin e të ardhurave të veta faktike prej **rreth 29.4 miliard lekë**. Një pjesë e bashkive si Belsh, Delvinë, Malësi e Madhe, Poliçan etj kanë një raport mjaft të lartë mbi 100% të stokut të detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2021, ndërkohë që ky raport është i vogël në bashki me kapacitet fiskal të madh si Tirana, Shkodra, Korca, Vlora etj.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore në drejtim të realizimit të buxhetit gjatë vitit 2021 kanë realizuar treguesit fiskalë të të ardhurave dhe shpenzimeve si më poshtë vijon:

- Rreth 20 bashki kanë patur rënie të të ardhurave gjatë vitit 2021, ku normën më të lartë të rënies me **rreth 37%** e ka **bashkia “Delvinë”**, ndërkohë që pas kësaj bashkie një normë të lartë rënie gjithashtu ka **bashkia “Pukë” me 31% dhe bashkia “Kukës” me 30%**.
- Pjesa tjetër prej 41 njësi të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2021 kanë patur një rritje në norma të ndryshme të të ardhurave, ku normën më të lartë të **rritjes e ka bashkia “Mallakastër” me 98%** më shumë të ardhura dhe pas saj vjen **bashkia “Himare” me 80%** më shumë të ardhura krahasuar me vitin 2020.
- Gjatë vitit 2021 evidentohet një rritje e ndjeshme me rreth **1.5 miliard lekë** i të ardhurave të NJVQV-ve nga **“Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”**, rritje ka dhe zëri **“Taksa të tjera” me rreth 1.1 miliard lekë**, “Tarifa pastrimi dhe higjene” me rreth 500 milion lekë si dhe një rritje rreth 600 milion lekë i të ardhurave jotatimore në raport me vitin 2020.
- Zëri që zë peshën më të madhe të të ardhurave vendore është **“taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” në rreth 32% të totalit të të ardhurave të veta vendore prej 29.4 miliard lekë**. Pas këtij zëri një peshë të rëndësishme me **rreth 15% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor e zë “taksa mbi ndërtesën”** dhe po në të njëjtën masë zënë të ardhurat nga “tarifa e pastrimit dhe higjenës”.
- **Bashkia Tiranë me rreth 7.2 miliard lekë ose ndryshe rreth 76% të totalit të të prej 9.4 miliard lekë** zë pjesën më të madhe të të ardhurave nga “taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”. **Zëri i taksës së ndikimit në infrastrukturë është vetëm 7.4% të totalit të të ardhurave vendore** nëse të ardhurat e Bashkisë Tiranë nga ky burim do ti zbrisim nga të ardhurat totale të pushtetit vendor.

- Bashkitë me nën 50,000 banorë (44 bashki) kanë realizuar të ardhura **pesha e realizimit të secilës prej tyre zë 0 deri 0.6 % të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë.**
- Për bashkitë nga 50,000-100,000 banorë (10 bashki) kanë realizuar të ardhura pesha e realizimit të secilës prej tyre zë 0.2 – 2.3 % **të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë.**
- Për bashkitë nga 100,000 – 150,000 banorë (3 bashki) Vlorë Fier dhe Kamëz kanë realizuar të ardhura pesha e realizimit të secilës prej tyre zë 2 deri në 3% **të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë.**
- Për bashkitë me më shumë se 150,000 banorë (4 bashki) nga të cilat 3 kanë realizuar të ardhura pesha e realizimit të secilës prej tyre zë 2.5 % -4.6 % **të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë** (Shkodër, Elbasan, Durrës), dhe vetëm **bashkia Tiranë me 57.2 %.**
- Pushteti vendor ka financuar në pjesën më të madhe funksionin e **“Shërbimeve të përgjithshme publike” dhe “Arsimit”, përkatësisht në masën 23.4% dhe 19.5% të totalit të shpenzimeve vendore.**
- Si rrjedhojë e përmirësimit të ecurisë së treguesve konstatohet që të gjitha funksionet kanë patur rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2021 krahasuar me një vit më parë me përjashtim të funksionit **“Çështjet ekonomike” i cili ka patur një rënie prej -2%.**
- Rreth 8 bashki nga totali kanë patur një rënie të shpenzimeve në vitin 2021 në raport me shpenzimet e realizuara në vitin 2020. Bashkitë që kanë patur rënien më të madhe janë bashkitë **“Shijak” me një rënie prej 54%, bashkia “Rrogozhinë” me rreth 23% apo bashkia “Pustec” me rreth 12% rënie të shpenzimeve.**
- Nga ana tjetër, pjesa më e madhe (53 bashki) kanë patur rritje të shpenzimeve në vitin 2021 në raport me vitin 2020. Bashkitë të cilat kanë patur rritjen më të madhe të shpenzimeve gjatë **vitit 2021 janë bashkitë si: bashkia “Vorë” me një rritje prej 65% apo bashkia “Tropojë” me një rritje prej 60% në raport me vitin 2020.**
- Pushteti vendor gjithashtu, në fund të vitit 2021 ka trashëguar për vitin 2022 si **pasojë e tejkalimit të planit të të ardhurave e mosrealizimit të shpenzimeve rreth 20 miliard lekë.** Nga ky trashëgim pjesën më të madhe e zë bashkia Tiranë **me rreth 10 miliard lekë ose 50% të totalit të trashëgimit.**

Forcimi i kapacitetit fiskal dhe kapaciteteve të burimeve njerëzore për zbatimin e funksioneve ligjore është një ndër synimet bazë të forcimit të rolit të pushtetit vendor. Duke ju referuar praktikave dhe asistencës më të mirë ndërkombëtare të menaxhimit të financave publike në nivel vendor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka krijuar hapësirën e nevojshme për orjentimin e politikave publike vendore mbi bazën e performancës buxhetore.

Në këtë kontekst, kjo analizë vjetore thekson rëndësinë e menaxhimit të financave në cilësinë e shërbimeve që përfitojnë qytetarët, si një formë për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë

e përdorimit të parave publike. Vazhdimësia e këtij raporti vjetor do të shërbejë si një bazë e rëndësishme zyrtare e të dhënave fiskale të pushtetit vendor, por gjithashtu krahasimi me ecurinë e tyre ndër vite.

Ky raport është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Drejtorisë së Financave Vendore dhe me mbështetjen e projektit “Financat lokale” nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështjet Ekonomike.

**Raporti i treguesve fiskalë  
vendore 2021**

**K**onsolidimi i menaxhimit financiar në nivel vendor në treguesit fiskalë të vitit 2021, paraqitet për të gjitha kategoritë e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel njësie të vetëqeverisjes vendore. Në këtë raport, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të analizojë jo vetëm trendet vjetore të detajuara në nivel llogarie dhe njësie vendore, por gjithashtu paraqet një dimension të rëndësishëm të treguesve të autonomisë financiare të pushtetit vendor. Në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe akteve nënligjore, njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit buxhetor 2021, kanë përmirësuar ndjeshëm procedurat në të gjitha hapat e menaxhimit financiar përfshirë këtu, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit. Ndryshimet metodologjike të aprovuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në hartimin e PBA-së, synojnë buxhetimin në nivel produkti dhe menaxhimin mbi bazë performance. Në realizimin e treguesve fiskale të vitit 2021, konstatohen përmirësime në drejtim të mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave, në kryerjen me efikasitet të shpenzimeve dhe në mbajtjen e kontabilitetit publik, duke u reflektuar në këtë mënyrë në shërbime publike me një efikasitet më të lartë.

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2021, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka qënë vazhdimi i konsolidimit të procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhimit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Disa prej arritjeve më të rëndësishme në proceset e menaxhimit të financave vendore gjatë vitit 2021, paraqiten si më poshtë:

- a) Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore përmes rritjes së peshës së taksave lokale në të ardhurat vendore. Të ardhurat tatimore të pushtetit vendor në vitin 2021 kanë pësuar një rritje të ndjeshme me rreth 4.6 miliard lekë ose rreth 21.3 % më shumë se në vitin 2020;
- b) Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale) nga 26.1 miliard lekë në vitin 2020, në 27.7 miliard lekë në vitin 2021 ose rreth 6.2 % më shumë financim nga pushteti qendror.
- c) Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale në vlerën 794.6 milion lekë; Shpërndarja e plotë e këtij burimi u dha mundësi financiare shtesë njësive të vetëqeverisjes vendore për të amortizuar vështirësitë dhe rritur efektivitetin e shërbimeve.

- d) Reforma e iniciuar nga Qeveria (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) në taksën e pasurisë është reflektuar në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga kjo taksë, nga 5.1 miliard lekë në vitin 2020 në 6.1 miliard lekë në vitin 2021, ose rreth 20 % më shumë se në vitin 2020.
- e) Në buxhetin e vitit 2021, është akorduar për njësitë e vetëqeverisjes vendore transfertë sektoriale për emergjencat civile në vlerën e 500 milion lekë;
- f) Akordimi i fondit në masën 500 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga ish-komunat.
- g) Rritja në masën 15 % e pagave të arsimit parashkollor (edukatorë + punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve) me një fond prej 380 milion lekë.
- h) Përmirësimet e metodologjive në hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti;
- i) Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj NJVQV-ve, në të gjitha hapat e menaxhimit financiar në nivel vendor përmes komenteve dhe konsultimit jo vetëm të hartimit të programit buxhetor afatmesëm por edhe të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit 2021.
- j) Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, si një detyrim ligjor për të monitoruar situatën financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore;
- k) Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me NJVQV-të në kuadër të masave të marrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për implementimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.

Raporti vjetor i realizimit të buxhetit vendor 2021, është bazuar mbi të dhënat zyrtare të përpunuara nga Drejtoria e Financave Vendore për 61 Bashki dhe 12 Këshillat e Qarkut në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), si dhe informacioni zyrtar mbi buxhetet vendore i përcjellë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto të dhëna janë përpunuar nga grupi i punës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë së bashku me asistencën e Projektit “Financat Lokale” të financuar nga Qeveria Zvicerane/SECO. Në funksion të analizës për numrin e popullsisë është përdorur treguesi sipas përcaktimeve të formulës së transfertës së pakushtëzuar në formën e banorëve rezidentë efektivë<sup>1</sup>.

Ky raport mbi zbatimin e financave vendore 2021, është vazhdimësi e raporteve vjetore të publikuara në vitet 2020, 2019 dhe 2018 edhe të analizave integrale mbi ecurinë e financave publike pjesë e rëndësishme e të cilës janë dhe financat vendore. Kjo analizë zyrtare do të shërbejë si bazë e të dhënave zyrtare për pushtetin vendor edhe për raporte të tjera të cilat mund të publikohen në të ardhmen.

1. Banorë rezidentë efektivë = [CENSUS + (Regjistri i gjendjes civile – Census) \* 30%]

**Menaxhimi Financiar  
Publik në nivel vendor  
dhe Autonomia Fiskale  
Vendore gjatë vitit 2021**

**P**ushteti Vendor pas reformës administrative territoriale dhe miratimit të ligjit bazë për financat e vetëqeverisjes vendore, hyri në një fazë të rëndësishme të konsolidimit fiskal të menaxhimit financiar publik. Një objektivi i rëndësishëm pjesë e reformës ishte edhe krijimi i kushteve të nevojshme ligjore dhe administrative për thellimin e autonomisë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Përmirësimet në menaxhimin financiar publik dhe konsolidimi financiar do të analizohen në këtë kapitull përmes një seti të treguesve të autonomisë si më poshtë vijon:


## 1. Të ardhurat e veta ndaj totalit të të ardhurave të NJVQV-ve

Një ndër objektivat më të rëndësishëm të reformës ishte rritja e treguesit të autonomisë fiskale që vjen si raport i të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2021 të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore në nivel kombëtar përfshirë të ardhurat tatimore dhe jotatimore **prej 29.4 miliard lekë**, ndaj të ardhurave totale prej **55.5 miliard lekë** ku përfshihen edhe transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale zënë rreth 53%.

Referuar treguesve në grafikun e mësipërm, konstatohet që vetëm 6 bashki si: Durrës, Tiranë, Roskovec, Sarandë, Himarë dhe Vorë kanë një raport mbi 50% të të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave vjetore 2021. Ndërkohë pjesa tjetër e njësive të vetëqeverisjes vendore kanë një tregues të autonomisë financiare nën 50% të të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave.

Ndërkohë, nëse në analizë do të përllogaritej mesatarja e këtij raporti, në 61 bashki rreth 34 prej tyre kanë një vlerë më të ulët se mesatarja prej 29% e të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave si tregues i rëndësishëm i autonomisë.

**Grafiku 1: Të ardhurat e veta ndaj totalit të të ardhurave vendore**



**Burimi:** Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);


## 2. Transferta e pakushtëzuar ndaj të ardhurave të veta të NJVQV-ve

Përcaktimi i transfertës së pakushtëzuar në ligjin për financat vendore jo më pak se 1% e PBB-së, ishte një hap i rëndësishëm që u siguroj njësisive të vetëqeverisjes një burim financiar të qëndrueshëm për financimin e funksioneve ligjore. Në këtë drejtim në nivel kombëtar transferata e pakushtëzuar prej rreth **18.4 miliard lekë në vitin 2021 zë rreth 62.5%** në raport me 29.4 miliard lekë nga të ardhurat e veta të njësisive të vetëqeverisjes vendore. Në formë të detajuar në nivel bashkie ky raport paraqitet si në grafikun e mëposhtëm:

Një pjesë e konsiderueshme e njësisive të vetëqeverisjes vendore aktualisht kanë një raport mbi 100% të transfertës së pakushtëzuar ndaj të ardhurave të veta, duke evidentuar në këtë mënyrë nevojën për thellimin e decentralizimit fiskal si formë për të ulur këtë raport. Kryesisht, bashki me një kapacitet fiskal të madh si Tirana, Durrësi, Fieri apo ato bashki të cilat kanë një burim specifik të të ardhurave kanë një raport të ulët të transfertës ndaj të ardhurave të veta.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të vijojë punën në drejtim të nxitjes së politikave decentralizuese fiskale me qëllim që njësitë e vetëqeverisjes vendore të ndryshojnë balancën e këtij raporti në drejtim të rritjes së të ardhurave të veta ndaj transfertës së pakushtëzuar. Ky tregues gjithashtu evidenton nivelin e lartë të varësisë fiskale të shumë njësisive të vetëqeverisjes vendore si Memaliaj, Pusteci, Hasi, Bulqiza etj ndaj transfertave të buxhetit qendror.

**Grafiku 2: Transferta e Pakushtëzuar ndaj të ardhurave të veta vendore**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);


### 3. Transferta e pakushtëzuar sektoriale ndaj të ardhurave të veta të NJVQV-ve

Njësiti e vetëqeverisjes vendore për funksionet e transferuara me ligj, përfitojnë në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale një mbështetje buxhetore nga qeveria qendrore që në vitin 2021 ka qënë në vlerën **rreth 8.2 miliard lekë**. Në raport me të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore që janë në vlerën rreth **29.4 miliard lekë**, kjo transfertë për mbulimin e këtyre funksioneve **është rreth 27.8%**.

Në grafikun e mëposhtëm, evidentohet qartë që bashki të vogla dhe me kapacitet mjaft të ulët fiskal të tilla si Fushë-Arrëzi, Memaliaj apo Pusteci kanë një raport mjaft të lartë të transfertave sektoriale ndaj totalit të të ardhurave vendore. Këto bashki që kanë një vlerë të lartë të këtij raporti tregojnë që pjesën e konsiderueshme të funksioneve që ato aktualisht ushtrojnë e mbulojnë përmes transfertës së buxhetit qendror.

Nga ana tjetër, njësiti e vetëqeverisjes vendore të cilat kalsifikohen si të mëdha në raport me buxhetin vjetor 2021 që ato kanë në dispozicion, kanë një raport të ulët të transfertës së pakushtëzuar sektoriale me të ardhurat e veta. Ulja e këtij raporti është një sfidë në bashkitë e vogla, në drejtim të nxitjes së rritjes së të ardhurave të veta vendore dhe kapacitetit fiskal që këto njësi kanë në raport me autonominë për të ushtruar funksionet që kanë në bazë të përcaktimeve ligjore.

**Grafiku 3: Transferta e Pakushtëzuar sektoriale ndaj Të ardhurave të veta vendore**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);


#### 4. Shpenzimet e personelit ndaj transfertës së pakushtëzuar;

Pas reformës administrative territoriale një objektiv i rëndësishëm ishte nxitja e uljes së shpenzimeve të personelit, e rritjes së shpenzimeve kapitale, që domosdoshmërisht do të ktheheshin në një eficiencë në rritje të menaxhimit financiar në nivel vendor. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2021, nga **24.1 miliard lekë shpenzime personeli** të njësisve të vetëqeverisjes vendore në raport me **18.4 miliard lekë** që buxheti qendror jep në formën e transfertës së pakushtëzuar, rezulton një **raport prej 131%**. Ky tregues në nivel bashkie paraqitet si në grafikun e mëposhtëm:

Si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel njësie vendore, gjatë vitit 2021 bashkitë kanë patur një rritje të shpenzimeve të personelit tregues ky i cili është reflektuar edhe në raport me transfertën e pakushtëzuar. Aktualisht një pjesë e bashkive si: Tiranë, Vorë, Kavajë, Sarandë, Gjirokastrë kanë një nivel mjaft të lartë të këtij raporti në krahasim me pjesën tjetër të bashkive. Ndërkohë konstatohet një trend i qëndrueshëm i një raporti të përafërt në të gjitha bashkitë ndërmjet shpenzimeve të personelit dhe transfertës së pakushtëzuar.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore në raport me këtë tregues duhet të marrin masat që të ulin pesha e treguesit përmes zvogëlimit të shpenzimeve të personelit. Bashkitë me kapacitet të lartë fiskal njëkohësisht kanë shpenzime të larta personeli të cilat tejkalojnë vlerën e transfertës që këto njësi marrin nga pushteti qendror. Rritja e transfertës dhe ulja e shpenzimeve të personelit do të japin mundësinë njësisve të vetëqeverisjes vendore të financojnë më shumë shërbime publike dhe investime që përmirësojnë drejtpërdrejt jetën e qytetarëve.

**Grafiku 4: Shpenzime Personeli ndaj Transfertës së Pakushtëzuar**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);


## 5. Shpenzime Kapitale ndaj Transfertës së pakushtëzuar;

Investimet publike në nivel vendor kanë një impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve, dhe si rrjedhim një objektiv i rëndësishëm i reformës territoriale dhe fiskale kishte qëllim krijimin e kushteve për njësitë e vetëqeverisjes vendore që të rrisin shpenzimeve kapitale. Në raport me transfertën e pakushtëzuar prej **rreth 18.4 miliard lekë**, gjatë vitit 2021, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë realizuar shpenzime kapitale në vlerën **e rreth 11.2 miliard lekë të cilat zënë 60% të transfertës së pakushtëzuar**. Si më poshtë paraqitet ky raport sipas njërive të vetëqeverisjes vendore:

Rënia e këtij raporti për një pjesë pjesë të konsiderueshme të njërive të vetëqeverisjes vendore është një tregues negativ i peshës së shpenzimeve kapitale në buxhetin e bashkive në raport me transfertën e pakushtëzuar të buxhetit qendror. Përsa u përket këtij treguesi për bashki si Tepelenë, Libohovë etj tregojnë qartë që pjesa më e madhe e bashkive kanë një nivel të ulët investimesh në raport me burimet e tjera të të ardhurave.

Në këtë drejtim, marrja e masave në rritjen e shpenzimeve kapitale do të reflektohej drejtpërdrejt në treguesin e raportit ndaj transfertës së pakushtëzuar por gjithashtu edhe në mirëqënien e qytetarëve.

**Grafiku 5: Shpenzime Kapitale ndaj Transfertës së Pakushtëzuar**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);


## 6. Shpenzime Kapitale ndaj të ardhurave të veta vendore;

Njësitë e vetëqeverisjes vendore gjithnjë dhe më shumë duhet që përmes të ardhurave të veta të financojnë shpenzimet për investime. Rritja e shpenzimeve për investime të pushtetit vendor në raport me të ardhurat e veta që NJVQV-të krijojnë është një tregues i qartë i eficiencës së menaxhimit financiar. Gjatë vitit 2021, pushteti vendor ka realizuar rreth **11.2 miliard lekë shpenzime për investime** dhe në raport me **të ardhurat e veta vendore prej rreth 29.4 miliard lekë**, këto shpenzime zënë **vetëm 38%**. Kjo peshë e ulët e shpenzimeve kapitale është një tregues për nxitjen e pushtetit vendor në drejtim të forcimit të investimeve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Si në grafikun e mëposhtëm paraqitet ky raport gjatë vitit 2021 për të gjitha NJVQV-të

Duke marrë në analizë bashkitë e mësipërme konstatohet që, ky raport si pasojë e nivelit të ulët të të ardhurave të veta vendore si Bulqiza, Memaliaj, Tropoja etj, është mjaft i lartë në mbi 100%. Ndërkohë, bashki me kapacitet të lartë fiskal si Tirana, Vlora, Durrësi, Elbasani, Fieri, Korça etj, kanë një nivel nën 50% të këtij raporti.

Për sa më sipër, nga ky tregues duhet të nxitet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore rritja e shpenzimeve për investime nga të gjitha burimet jo vetëm nga të ardhurat e veta vendore por edhe nga transfertat e buxhetit qendror.

**Grafiku 6: Shpenzime Kapitale ndaj të ardhurave të veta vendore**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

## 7. Detyrimet e parapambetura ndaj totalit të ardhurave të veta vendore;


Një shqetësim për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është krijimi i detyrimeve të parapambetura të cilat gjatë vitit 2021 kanë ardhur në rritje në raport me një vit më parë. Një aspekt i rëndësishëm i analizës mbi detyrimet e parapambetura të njësisve të vetëqeverisjes vendore është evidentimi i arsyes kryesore pse këto detyrime krijohen si dhe përse stoku i tyre nuk ka pësuar një rënie të ndieshme në vite. Gjatë vitit 2021, ky raport nga stoku i **detyrimeve të parapambetura prej rreth 6.6 miliard lekë** në nivel kombëtar mbi totalin e të ardhurave të veta faktike prej **rreth 29.4 miliard lekë** rezultojnë të jetë prej rreth 22.4%. Si në grafikun e mëposhtëm, paraqitet raporti i stokut të detyrimeve të parapambetura ndaj të ardhurave të veta vendore sipas bashkive.

Në grafikun e mëposhtëm konstatohen që një pjesë e bashkive të tilla si Belsh, Delvinë, Malësi e Madhe, Poliçan etj kanë një raport mjaft të lartë mbi 100% të stokut të detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2021 ndaj të ardhurave të veta që këto njësi kanë realizuar. Kapaciteti fiskal mjaft i ulët i këtyre bashkive dhe menaxhimi jo i mirë i mbledhjes së të ardhurave dhe planifikimit të shpenzimeve ka krijuar këto problematika në stokun e detyrimeve.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e NJVQV-ve si: Tirana, Shkodra, Korca, Vlora etj, kanë një raport mjaft të ulët të stokut të detyrimeve në vitin 2021 mbi të ardhurat e veta. Kapaciteti fiskal i qëndrueshëm dhe cilësia e lartë e menaxhimit financiar është treguesi më i rëndësishëm i këtyre bashkive që do të reflektohet në cilësinë e shërbimeve ndaj qyteratëve.

Për sa më sipër, njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë një raport mbi 100% të stokut të detyrimeve ndaj të ardhurave të veta faktike, duhet të marrin masa të menjëhershme jo vetëm në drejtim të shlyerjes së detyrimeve por gjithashtu të rritjes së kapacitetit fiskal.

**Grafiku 7: Detyrimet e prapambetura ndaj totalit të të ardhurave vendore**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);


## 8. Detyrimet e prapambetura ndaj planit të shpenzimeve vjetore;

Për të evidentuar më qartë problematikën e krijimit të detyrimeve të prapambetura, ato janë vendosur në raport me planin e shpenzimeve vejtore të parashikuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjatë vitit 2021 në nivel kombëtar, stoku i **detyrimeve të prapambetura prej 6.6 miliard lekë zë rreth 8.8% të totalit të planit të shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore prej 74.8 miliard lekë**. Si në grafikun e mëposhtëm, ky raport gjatë vitit 2021 paraqitet për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ashtu sic mund të konstatohet në grafikun e mëposhtëm, me përjashtim të bashkisë Belsh, Kavajë dhe Malësi e Madhe ku ky raport kalon raportin mbi 50% të detyrimeve të prapambetura ndaj planit fillestar të shpenzimeve, pjesa tjetër e të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore janë në një raport mjaft të ulët.

Ky tregues evidenton qartë faktin që kapaciteti i ulët fiskal dhe parashikimi jo realist i planit të shpenzimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore janë arsyet kryesore të rritjes së stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore. Krijimi i një plani realist të të ardhurave të veta vendore duke shmangur në këtë mënyre marrjen e agazhimeve buxhetore mbi të cilin ka kapacitet fiskal bashkia, është masa imediate e cila do të shmangë rritjen e stokut aktual të detyrimeve të prapambetura dhe uljen e tij në të ardhmen.

**Grafiku 8: Detyrimet e Prapambetura ndaj planit vjetor të shpenzimeve**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);


## 9. Transferta e buxhetit qendror ndaj të ardhurave të veta vendore.

Pas reformës adminstrativo territoriale, një aspekt i rendësishëm për menaxhimin financiar në nivel vendor ishte rritja e autonomisë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore në raport me transfertat që ato njësi presin nga qeveria qendrore. Në këtë aspekt, gjatë vitit 2021, në nivel kombëtar njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë marrë në formën e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe sektoriale **rreth 27.7 miliard lekë**, ku në raport me të ardhurat e veta vendore prej 29.4 miliard lekë, ato janë **sa 94% e të ardhurave të veta vendore**. Ky raport në nivel bashkie paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Për sa konstatohet në grafikun e mëposhtëm, shumë njësi të vetëqeverisjes vendore kanë një raport mjaft të lartë të transfertës së buxhetit qendror ndaj të ardhurave të veta vendore. Ky tregues për bashki të tilla si Memaliaj, Pustec, Fushë-Arrëz me një kapacitet mjaft të ulët fiskal, tregon varësinë lartë që kanë këto bashki nga transfertat e buxhetit qendror. Ky tregues tregon qartë që pas reformës mungesa e një decentralizimi fiskal të thelluar është reflektuar në një nivel të lartë varësie, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e bashkive kanë kapacitet të ulët fiskal për të financuar shpenzimet për shërbime publike.

Në këtë drejtim, me qëllim për të nxitur politikat vendore për përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve duhet të merren masat e nevojshme për uljen e këtij raporti. Krijimi i bashkive me kapacitet të lartë fiskal përmes thellimit të decentralizimit të burimeve të veta vendore do të jetë një siguri në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve publike dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve.

**Grafiku 9: Transferta nga buxheti qendror ndaj të ardhurave të veta vendore**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

**Treguesit fiskalë të  
pushtetit vendor gjatë vitit  
2021**

**M**inistria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2021, ka ndjekur me përparësi ecurinë e treguesve fiskalë të pushtetit vendor, si për treguesit në nivel kombëtar ashtu edhe situatën e njësisive të vetëqeverisjes vendore. Analiza e treguesve të pushtetit vendor do të shërbejë si një pjesë e rëndësishme e analizës në nivel kombëtar dhe ecurisë së reformave në raport me objektivat e decentralizimit dhe mirëqeverisjes.

Gjatë vitit 2021, pushteti vendor ka realizuar të ardhura të veta tatimore dhe jotatimore rreth 29.4 miliard lekë ose ndryshe rreth **5.2 miliard lekë më shumë** se realizimi prej 24.2 miliard lekë i të ardhurave të veta vendore gjatë vitit 2020. Nga të ardhurat e veta vendore, gjatë vitit 2021 rreth 2.8 miliard lekë janë të ardhura jotatimore dhe pjesa tjetër prej 26.6 miliard lekë janë të ardhura tatimore të pushtetit vendor. Të ardhurat tatimore të pushtetit vendor janë realizuar në masën rreth 103% e planit vjetor 2021, pra rreth 26.6 miliard lekë nga 25.9 miliard lekë të parashikuara në treguesit fiskalë të konsoliduar. Nga ana tjetër, pushteti vendor gjatë vitit 2021, ka realizuar rreth 52.6 miliard lekë shpenzime për financimin e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Këto shpenzime janë realizuar rreth 91% e planit vjetor të treguesve fiskalë të konsoliduar prej 57.9 miliard lekë. Treguesit e planifikuar fiskalë dhe të realizuar të të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor gjatë vitit 2021 paraqiten si në grafikun më poshtë:


**Grafiku 10: Plan/Fakt i të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor gjatë vitit 2021**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Nëse në analizë do të marrim realizimin mujor të të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor gjatë vitit 2021, në muaj të ndryshëm ka patur luhatje duke krijuar në shumë raste disbalanca të cilat janë mbuluar nga përdorimi i burimeve të tjera si transfertat e buxhetit qendror. Shpërndarja e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas muajve është realizuar sipas grafikut të mëposhtëm:

**Grafiku 11: Realizimi mujor i të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor 2021.**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Nga analiza e treguesve në grafikun e mësipërm evidentohet qartë ruajtja e trendeve të njëjta të realizimit të shpenzimeve të pushtetit vendor në muaj dhe të ardhurave të veta vendore të realizuara. Pushteti vendor ka ruajtur trendet ciklike 4 mujore të akumulimit të të ardhurave të veta vendore dhe gjithashtu të ecurisë së realizimit të shpenzimeve në funksion të shërbimeve publike. Në dy muajt e parë të vitit 2021, pushteti vendor ka realizuar një nivel të ulët të të ardhurave, ndërkohë që shpenzimet vendore kanë ruajtur gjithashtu një trend të kufizuar si pasojë e tkurrjes ekonomike në tërësi. Megjithatë në realizimin e të ardhurave, situata ka ardhur duke u përmirësuar në muajt në vazhdim. Ruajtja e qëndrueshmërisë së menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore paraqesin një disiplinë të shtuar në raport me procesin e menaxhimit financiar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Tremujori i dytë i vitit 2021, ka siguruar vlerën më të lartë të të ardhurave **ose rreth 9 miliard lekë nga 26.4 miliard lekë** të akumuluar në të gjithë vitin 2021.

Gjithashtu, një trend jo i zakonshëm i shpenzimeve vendore konstatohet në muajin dhjetor 2021, ku vetëm gjatë këtij muaji janë realizuar rreth 7.1 miliard lekë shpenzime ose rreth 13.5% e totalit prej 52.6 miliard lekë të realizuara gjatë vitit 2021. Ky trend i realizimit të shpenzimeve nuk është në të njëjtin nivel me realizimin vetëm të 1.6 miliard lekë të ardhura të veta vendore në muajin dhjetor 2021.

Në kuadër të mirëmenaxhimit financiar në nivel vendor me qëllim shmangien e trendit të relizimit shumë të madh të shpenzimeve në fund të vitit, kryesisht shpenzimeve për investime, është i nevojshëm rekomandimi për realizimin e shpenzimeve nën një plan të detajuar mujor i cili mundëson disiplinën e shpenzimeve dhe shmangien e mundësisë për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

**Grafiku 12: Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin 2021 dhe vitin 2015.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Reforma administrativo-territoriale dhe autonomia fiskale dha një efekt të konsiderueshëm në potencialin financiar të pushtetit vendor, duke rritur jo vetëm kapacitetet për mbledhjen e të ardhurave të veta vendore por gjithashtu edhe në rritjen e shpenzimeve për shërbimet vendore. Në raport me vitin 2015, si viti para reformës, të ardhurat tatimore nga 11.7 miliard kanë arritur në vitin 2021 vlerën rreth 26.6 miliard lekë osë e thënë ndryshe një rritje rreth 127%. Nga ana tjetër shpenzimet vendore prej 52.6 miliard lekë në vitin 2021, u rritën me rreth 54.4% në raport me realizimin e shpenzimeve të pushtetit vendor në vitin 2015 prej 34 miliard lekë. Kjo rritje e konsiderueshme në kapacitetin fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore, ishte një provë mbi rëndësinë që mori reforma në menaxhimin financiar publik të njësive të vetëqeverisjes vendore.


## 3.1 Të ardhurat e pushtetit vendor

Rritja e të ardhurave të veta vendore në kuadër të konsolidimit të ecurisë së decentralizimit, krijoj kushtet e favorshme për një pjesë të konsiderueshme të njësive të vetëqeverisjes vendore për të nxitur politikat e reja në drejtim të cilësisë së shërbimeve publike. Duke marrë në konsideratë rëndësinë që kanë të ardhurat e veta të pushtetit vendor për menaxhimin e shërbimeve publike, në këtë seksion do të analizohen të gjitha burimet kryesore të të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2021, pushteti vendor ka realizuar në total rreth 26.6 miliard lekë të ardhura nga taksat vendore ose thënë ndryshe rreth 5 miliard lekë më shumë krahasuar me të ardhurat e vitit 2020. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi të ardhurat jotatimore gjatë vitit 2021 janë mbledhur rreth 2.8 miliard lekë ose ndryshe rreth rreth 300 milion lekë më shumë të ardhura nga ky burim në raport me vitin 2020. Parë në këndvështimin e treguesve, gjatë vitit 2021 pushteti vendor është konsoliduar në burimet e financimit nga të ardhurat e veta vendore.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat në mijë lekë të realizimit të këtyre burimeve gjatë vitit 2021-2020:

**Grafiku 13: Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore në vitin 2021 dhe 2020.**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Rritja e kapacitetit të pushtetit vendor në drejtim të ofrimit të shërbimeve publike mbështetur mbi funksionet që ka në kompetencë, ka bërë që raporti i të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave publike dhe produktit të brendshëm bruto të ndryshojë me rritje në vitet e fundit. Të ardhurat e pushtetit vendor, paralelisht me rritjen në vlerë absolute gjatë vitit 2021 si pasojë e mirëmenaxhimit të burimeve të veta vendore, në raport me të ardhurat publike janë rritur **nga 5.16% në vitin 2020**

**në 5.22%** në vitin 2021. Nga viti 2015, ku raport i të ardhurave vendore me të ardhurat publike ishte rreth 3.09%, rritja e rolit dhe fuqisë fiskale të pushtetit vendor në vitin 2021 u shoqërua me rritje të këtij raporti me rreth 2.13%. Nga ana tjetër, pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi e në Produktin e Brendshëm Bruto duke ndryshuar raportin e të ardhurave të veta vendore në raport me të ardhurat e buxhetit të shtetit, nga 0.82% e PBB në vitin 2015 në 1.51 % në vitin 2021, me një rritje prej 0.69% e PBB-së.


**Grafiku 14: Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Të ardhurat e pushtetit vendor në vite kanë ruajtur një trend rritje të ndjeshme, duke përcaktuar në këtë mënyrë ecurinë pozitive të aftësisë së pushtetit vendor për të siguruar të ardhura. Mbajtja e këtij ritmi të rritjes së të ardhurave nga viti 2015 e në vazhdim ka kondoliduar ndjeshëm potencialin fiskal të pushtetit vendor për të ofruar shërbime cilësore në nivel vendor.


**Grafiku 15: Të ardhurat tatimore të pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Rritja e potencialit ekonomik jo vetëm nga të ardhurat e veta por edhe nga ato të buxhetit qendror janë një faktor shumë i rëndësishëm në nxitjen për rritjen e cilësisë së shërbimeve të pushtetit vendor. Transferta e pakushtëzuar si një burim i rëndësishëm i financimit të pushtetit vendor në vite ka pësuar një rritje të ndjeshme. Kjo rritje vjetore e qëndrueshme e transfertave të buxhetit qendror si një burim i rëndësishëm i financimit të shërbimeve publike ka vazhduar gjithashtu gjatë vitit 2021. Rritja e transfertës së pakushtëzuar vjen për shkak të rritjes tërësore të produktit të brendshëm bruto gjatë vitit 2021, në kushtet kur transferta e pakushtëzuar është një tregues që llogaritet si përqindje e produktit të brendshëm bruto. Krahasuar me një vit më parë transferta e pakushtëzuar nga 18.2 miliard lekë në vitin 2020 ka arritur në vlerën e rreth 18.5 miliard lekë ose ndryshe me një rritje rreth 300 milion lekë.


**Grafiku 16: Transferta e pakushtëzuar në vite 2011-2021.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Gjatë vitit 2021, të ardhurat e veta vendore dhe ato nga transfertat e buxhetit qendror zënë një peshë pothuajse të barabartë, nga 52.6 miliard lekë që janë shpenzimet vendore gjatë vitit 2021, rreth 52% ose 26 miliard lekë e zënë shpenzimet me burim transfertat e buxhetit qendror, ndërkohë pjesa tjetër e këtyre shpenzimeve mbulohet nga të ardhurat e veta të pushtetit vendor dhe taksat e ndara. Gjatë viteve të fundit, ashtu siç mund të konstatohet në grafikun e mëposhtëm rritja e shpenzimeve vendore ka ardhur si rrjedhojë e rritjes konstante të të gjitha formave të burimit të të ardhurave vendore si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor.


## Grafiku 17: Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit në vite



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Rimëkëmbja ekonomike pas pandemisë e cila u reflektua në të gjithë treguesit e pushtetit vendor, sigurisht në tregeusit e vitit 2021 ky përmirësim reflektohet në trendin në rritje të të ardhurave por edhe të shpenzimeve. Në këto kushte, referuar grafikut të mëposhtëm gjatë vitit 2021 konstatohet një rritje e ndjeshme me rreth 1.6 miliard lekë i të ardhurave të NJVQV-ve nga “Taksa e ndikimit në infrastrukture”, gjithashtu një rritje ka dhe zëri i “Taksa të tjera” me 1.3 miliard lekë, nga “Tarifa pastrami dhe higjene” me rreth 500 milion leke apo me një rritje rreth 600 milion lekë të të ardhurave jotatimore në raport me vitin 2020.


**Grafiku 18: Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite**



**Burimi:** Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Ndërkohë nëse marrim në analizë disa nga burimet kryesore të të ardhurave të veta vendore gjatë vitit 2021, në nivelin e njërive të vetëqeverisjes vendore, pesha që zënë këto burime paraqitet si në grafikun e mëposhtëm:


**Grafiku 19: Pesa e të ardhurave sipas burimeve kryesore**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Nëse analizojmë rolin e këtyre burimeve të të ardhurave vendore sipas peshës që ato zënë në totalin e të ardhurave të pushtetit vendor për vitin 2021, do të evidentojmë se zëri që zë peshën më të madhe është **“taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” në rreth 32% të totalit të të ardhurave të veta vendore prej 29.4 miliard lekë.** Pas këtij zëri një peshë të rëndësishme me rreth 15% e totalit të të ardhurave të pushtetit vendor e zë “taksa mbi ndërtesën” dhe po me të njëjtën masë zënë të ardhurat nga “tarifa e pastrimit dhe higjenës” me rreth 15%. Duke parë të dhënat sipas bashkive konstatohet që pjesën më të madhe të të ardhurave nga “taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” e zë bashkia Tiranë me rreth 7.1 miliard lekë ose ndryshe rreth 76% të totalit të të ardhurave nga ky burim prej 9.4 miliard lekë. Nëse të ardhurat nga ky burim prej 7.1 miliard lekë të bashkisë Tiranë do ti zbresim nga të ardhurat totale të pushtetit vendor atëherë zëri i taksës së ndikimit në infrastrukturë do të zërë vetëm 7.4% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor në vitin 2021.


**Grafiku 20: Peshat e të ardhurave të pushtetit vendor sipas burimit në vitin 2021.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Nëse të ardhurat e veta vendore të pushtetit vendor do të grupohen nga të ardhurat në formën e taksave dhe tarifave, gjatë vitit 2021 do të konstatohet rritje në të ardhurat e këtyre burimeve në raport me vitin 2020. Të ardhurat nga tarifatat në vitin 2021 janë mbledhur vetëm 7.8 miliard lekë ose rreth 1.2 miliard lekë më shumë se të ardhurat e këtij burimi në vitin 2020. Ndërkohë të ardhurat nga taksat vendore në vitin 2021 janë akumuluar rreth 21.6 miliard lekë, ose rreth 4 miliard lekë më shumë se të ardhurat e taksave vendore prej 17.7 miliard gjatë vitit 2020. Në grafikun e mëposhtëm ilustrohen peshat që zënë të ardhurat nga taksat dhe të ardhurat nga tarifatat vendore gjatë vitit 2021 krahasuar me një vit më parë.


**Grafiku 21: Të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore gjatë vitit 2021**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Ndërkohë nëse marrim në analizë vetëm të ardhurat jotatimore krahasuar më të ardhurat e tjera nga taksat dhe tarifatat në nivelin e njësisive të vetëqeverisjes vendore, gjatë vitit 2021 konstatohet se një peshë të madhe të të ardhurave të veta vendore e zënë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat, ndërkohë të ardhurat jotatimore janë ato që mbështesin financimin e funksioneve më pak. Si në grafikun e mëposhtëm paraqitet pesha e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore dhe të ardhurat jotatimore gjatë viti 2021:

**Grafiku 22: Pesha e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore dhe të ardhurat jotatimore sipas NJVQV-ve gjatë vitit 2021**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Duke marrë në analizë efektin e ndryshimit të të ardhurave sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, do të konstatohet një shpërndarje uniforme të njësive të vetëqeverisjes vendore që kanë patur ndryshim negativ apo pozitiv nga viti 2020 në vitin 2021 të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Rreth 20 njësi të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2021 kanë patur një rënie të të ardhurave të veta vendore në raport me një vit më parë. Gjithashtu, konstatohet se rënia është në nivele mjet të ulëta e cila nuk afekton besueshmërinë në menaxhimin financiar të njësive së vetëqeverisjes vendore.

Rreth 14 njësi të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2021 kanë patur një rënie të të ardhurave të veta vendore në raport me një vit më parë. Normën më të lartë të rënies me rreth 31% më pak të ardhura e ka bashkia Kukës, ndërkohë që pas kësaj bashkie një normë të lartë rënieje është bashkia Pukë me 28% dhe bashkia Memaliaj me 19%. Pjesa tjetër e njësive të vetëqeverisjes vendore që rezultojnë me të ardhura më të ulta në vitin 2021 kundrejt vitit 2020, variojnë në normat e rënies nga 14% deri 1%. Megjithatë konstatohet se 47 njësi të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2021 kanë patur një rritje në norma të ndryshme të të ardhurave, ku normën më të lartë të rritjes e ka bashkia Kuçovë me 91% më shumë të ardhura dhe pas saj vjen bashkia Mallakastër me 89% , apo bashkia Himarë me 76% më shumë të ardhura krahasuar me vitin 2020.

Gjithashtu, duke u grupuar njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas banorëve, nuk konstatohet një lidhje ndërmjet normave të ndryshimit të të ardhurave dhe bashkive sipas madhësisë. Janë kryesisht faktorët kryesore ekonomike sipas vendndodhjes së njësive të vetëqeverisjes vendore që kanë ndikuar në ecurinë e të ardhurave të veta të pushtetit vendor. Njësitë e vetëqeverisjes vendore pavarësisht decentralizimit horizontal fiskal që kanë patur mbështeten në burime të caktuara të cilat ndryshojnë nga një njësi në tjetrën dhe sigurisht varen nga karakteristikat ekonomike e gjeografike të NJVQV-së.

**Grafiku 23: Norma e ndryshimit të të ardhurave të njëjste të vetëqeverisjes vendore 2021/2020**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Sa i përket shumës së mbledhur të të ardhurave të veta nga njësitet e vetëqeverisjes vendore, **bashkia Tiranë** zë vendin e parë me 16,847,471 mijë lekë, shumë **e cila përbën 57.2 % të totalit të të ardhurave të mbledhura nga të gjitha bashkitë**. Bashkia Durrës renditet në vendin e dytë me 1,365,018 mijë lekë, e cila përbën 4.6 % të totalit të të ardhurave mbledhura nga të gjitha bashkitë. Në vendin e tretë renditet bashkia Vlorë me 3%, për të vijuar me bashkitë Elbasan, Shkodër, Kamëz, Korçë, Fier dhe Himarë. Bashkitë të cilat kanë mbledhur nivelin më të ulët të të ardhurave vendore në raport me totalin e të ardhurave në rend zbritës pra deri në 10,000 mijë lekë secila janë: Bashkia Libohovë, Memaliaj dhe Pustec.

Nëse do ti referohemi totalit të të të ardhurave të veta vendore për vitin 2021, bashkitë grupohen si më poshtë:

- Me të ardhura në shumën 4,000 – 50,000 mijë lekë paraqiten 17 bashki (Bulqizë, Delvinë, Fushë-Arrëz, Has, Këlcyrë, Klos, Konispol, Libohovë, Memaliaj, Mirditë, Peqin, Përmet, Polican, Pukë, Pustec, Skrapar, Tepelenë)
- Me të ardhura në shumën 50,000 – 100,000 mijë lekë paraqiten 13 bashki (Belsh, Dibër, Dropull, Finiq, Gramsh, Kolonjë, Kurbin, Malësi e Madhe, Mat, Prenjas, Selenicë, Tropojë dhe Vau-Dejës)
- Me të ardhura në shumën 100,000 – 500,000 mijë lekë paraqiten 22 bashki (Berat, Cerrik, Devoll, Divjake, Gjirokaster, Kavaja, Krujë, Kucovë, Kukës, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Maliq, Mallakaster, Patos, Pogradec, Rogozhinë, Roskovec, Sarandë, Shijak, Ura Vajgurore, Vore)
- Me të ardhura në shumën më të madhe se 500,000 mijë lekë, 9 bashki (Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Shkodër, Kamëz, Korçë, Fier dhe Himarë).

Nëse do ti referohemi analizës sipas numrit të popullsisë:

- Bashkitë me nën 50,000 banorë (44 bashki) kanë realizuar të ardhura **pesha e realizimit të secilës prej tyre zë 0 deri 0.6 % të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë**.
- Për bashkitë nga 50,000-100,000 banorë (10 bashki) kanë realizuar të ardhura pesha e realizimit të secilës prej tyre zë 0.2 – 2.3 % **të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë**.
- Për bashkitë nga 100,000 – 150,000 banorë (3 bashki) Vlorë Fier dhe Kamëz kanë realizuar të ardhura pesha e realizimit të secilës prej tyre zë 2 deri në 3% **të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë**.
- Për bashkitë me më shumë se 150,000 banorë (4 bashki) nga të cilat 3 kanë realizuar të ardhura pesha e realizimit të secilës prej tyre zë 2.5 % -4.6 % **të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë** (Shkodër, Elbasan, Durrës), dhe vetëm bashkia Tiranë me 57.2 %.

Nr	Bashkia	Të ardhurat (në mijë lekë)	Pesha në %
1	Bashkia Belsh	76,937	0.3%
2	Bashkia Berat	350,902	1.2%
3	Bashkia Bulqize	44,939	0.2%
4	Bashkia Cerrik	112,740	0.4%
5	Bashkia Delvine	29,496	0.1%
6	Bashkia Devoll	115,294	0.4%
7	Bashkia Diber	99,225	0.3%
8	Bashkia Divjake	115,944	0.4%
9	Bashkia Dropull	52,456	0.2%
10	Bashkia Durres	1,365,018	4.6%
11	Bashkia Elbasan	808,927	2.7%
12	Bashkia Fier	631,819	2.1%
13	Bashkia Finiq	62,283	0.2%
14	Bashkia Fushe-Arrez	12,965	0.0%
15	Bashkia Gjirokaster	171,892	0.6%
16	Bashkia Gramsh	78,503	0.3%
17	Bashkia Has	16,586	0.1%
18	Bashkia Himare	539,165	2%
19	Bashkia Kamez	723,290	2%
20	Bashkia Kavaja	385,223	1.3%
21	Bashkia Kelcyre	14,932	0%
22	Bashkia Klos	27,576	0%
23	Bashkia Kolonje	56,785	0%
24	Bashkia Konispol	38,843	0.13%
25	Bashkia Korce	679,723	2.3%
26	Bashkia Kruje	255,515	0.9%
27	Bashkia Kucove	181,446	0.6%
28	Bashkia Kukes	107,256	0.4%
29	Bashkia Kurbin	67,759	0.2%
30	Bashkia Lezhe	457,707	1.6%
31	Bashkia Libohove	9,877	0.0%
32	Bashkia Librazhd	132,344	0.4%
33	Bashkia Lushnje	353,385	1.2%
34	Bashkia Malesi e Madhe	69,947	0.2%
35	Bashkia Maliq	100,294	0.3%
36	Bashkia Mallakaster	186,602	0.6%
37	Bashkia Mat	83,493	0.3%
38	Bashkia Memaliaj	10,525	0.0%
39	Bashkia Mirdite	42,279	0.1%

Nr	Bashkia	Të ardhurat (në mijë lekë)	Pesha në %
40	Bashkia Patos	190,034	0.6%
41	Bashkia Peqin	48,579	0.2%
42	Bashkia Permet	30,520	0.1%
43	Bashkia Pogradec	315,476	1.1%
44	Bashkia Polican	29,416	0.1%
45	Bashkia Prenjas	73,771	0.3%
46	Bashkia Puke	27,461	0.1%
47	Bashkia Pustec	4,137	0.0%
48	Bashkia Rogozhine	137,345	0.5%
49	Bashkia Roskovec	214,999	0.7%
50	Bashkia Sarande	415,597	1.4%
51	Bashkia Selenice	84,091	0.3%
52	Bashkia Shijak	141,800	0.5%
53	Bashkia Shkoder	726,766	2.5%
54	Bashkia Skrapar	45,446	0.2%
55	Bashkia Tepelene	46,794	0.2%
56	Bashkia Tirana	16,847,471	57.2%
57	Bashkia Tropoje	51,180	0.2%
58	Bashkia Ura Vajgurore	145,510	0.5%
59	Bashkia Vau-Dejes	81,877	0.3%
60	Bashkia Vlore	881,646	3.0%
61	Bashkia Vore	263,259	0.9%
<b>Total</b>		<b>29,473,071</b>	<b>100.0%</b>


Përsa i përket të ardhurave të mbledhura nga qarqet, qarku Lezhë zë vendin e parë me 21,850 mijë lekë, i cili përbën 86 % të të ardhurave të mbledhura total nga qarqet. Në vendin e dytë renditet qarku Elbasan me 1,296 mijë lekë të ardhura, i cili përbën 5 % të të ardhurave totale të mbledhura nga qarqet, më pas renditet qarku Vlorë të ardhurat e të të cilit zënë rreth 1.5% të totalit. Ndërkohë të ardhurat e secilit prej 9 qarqeve të tjera, përbëjnë 0.1deri në 1.4% në raport me totalin e të ardhurave të mbledhura nga qarqet.

Nr	Qarku	Të ardhurat (në mijë lekë)	Pesha ne %
1	Qarku Berat	370	1.46%
2	Qarku Dibër	186	0.73%
3	Qarku Durrës	45	0.18%
4	Qarku Elbasan-	1,296	5.11%
5	Qarku Fier	107	0.42%
6	Qarku Gjirokaster	177	0.70%
7	Qarku Korçë	358	1.41%
8	Qarku Kukës	283	1.12%
9	Qarku Lezhë	21,850	86.17%
10	Qarku Shkodër	92	0.36%
11	Qarku Tiranë	189	0.75%
12	Qarku Vlorë	402	1.59%
<b>Total</b>		<b>25,356</b>	<b>100.00%</b>

## 3.2 Shpenzimet e pushtetit vendor

Gjatë vitit 2021, pushteti vendor ka një rritje të shpenzimeve të cilat financohen nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar sektoriale dhe të përgjithshme, si dhe të ardhurat nga burimet e veta, me rreth 2% në raport me një vit më parë. Kjo rritje në vlerë absolute është evidentuar në masën rreth 1 miliard lekë më shume shpenzime gjatë vitit 2021 krahasur me vitin 2020.

**Grafiku 24: Realizimi i shpenzimeve të pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit në vite.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);


Ashtu siç mund të konstatohet në grafikun e mësipërm, shpenzimet e pushtetit vendor në vite kanë ndjekur një trend rritje duke konkretizuar konsolidimin e menaxhimit financiar të pushtetit vendor. Ky trend identifikohet qartë jo vetëm në vlerë absolute të shpenzimeve të pushtetit vendor por gjithashtu edhe në raport me produktin e brendshëm bruto apo shpenzimet publike. Ky trend në rritje i shpenzimeve ka vazhduar gjithashtu edhe në treguesit fiskalë të vitit 2021. Në raport me një vit më parë, gjatë vitit 2021 shpenzimet e **pushtetit vendor në raport me PBB, kanë pësuar një rënie të lehtë prej 0.22%**. Nga ana tjetër, **në raport me shpenzimet publike** të një viti më parë, gjatë vitit 2021 shpenzimet e pushtetit vendor patën **një rënie prej 0.75%**.

Një ndër faktorët bazë të kësaj rënie në nivelin e raportit të shpenzimeve vendore ndaj atyre publike janë ritmi i ecurisë së realizimit të shpenzimeve për investime i cili është me i ulët së një vit më parë. Marrë në krahasim me vlerën e trashëguar të fondeve për vitin

2022, konstatohet që një pjesë e konsiderueshme e këtij efekti financiar është trashëguar për tu shlyer në vitin 2022.

Ky raport është një ndër treguesit më të rëndësishëm që shpreh jo vetëm rolin e pushtetit vendor por gjithashtu edhe shkallën e decentralizimit fiskal të pushtetit vendor. Rritja e peshës së shpenzimeve vendore si në raport me produktin e brendshëm bruto gjithashtu edhe në raport me shpenzimet kombëtare janë tregues i rëndësishëm i nivelit të decentralizimit fiskal dhe një garanci e shtuar për përmirësimin e afetësisë së njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve publike.


**Grafiku 25: Realizimi i shpenzimeve të pushtetit vendor në vite dhe në raport me totalin të shpenzimeve publike e PBB.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Nga analiza e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike konstatohet që peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve gjatë vitit 2021 e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime që zënë rreth **45.9% të totalit të shpenzimeve vendore**. Në raport me një vit më parë konstatohet që **shpenzimet për investime kanë një rënie me rreth 1.7 miliard lekë**, ndërkohë që **shpenzimet e personelit kanë një rritje rreth 1.7 miliard lekë**, si dhe shpenzimeve operative janë rritur me rreth me **600 milion lekë** krahasuar me shpenzimet e vitit 2020. Pushteti vendor, pas përfundimit të situatës së krijuar nga pandemia e vitit 2020, gjatë vitit 2021 duhet të rikuperojë me ritme të shpejta mosrealizimet si në aspektin e burimeve të veta ashtu edhe në realizimin e investimeve që afektojnë drejtpërdrejt jetën e qytetarëve.


**Grafiku 26: Shpenzimet sipas llogarive ekonomike të pushtetit vendor për vitin 2021-2020.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

**Trendin e rënies më të madhe në vitin 2021 e kanë pësuar shpenzimet për investime, me rreth 13.1% më pak se viti 2020.** Njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2021 nuk arritën të ndalin trendin rënës të shpenzimeve për investime që ndodhi në vitin 2020 për shkak të ecurisë së realizimit të investimeve të ndikuara nga situata e COVID-19. Kjo diferencë e cila reflektohet në infrastrukturë dhe cilësi të shërbimeve, duhet të rikuperohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në shpenzimet e vitit 2022.


**Grafiku 27: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas kalsifikimit ekonomik 2021-2020**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Ndërkohë si në grafikun e mëposhtëm paraqitet pesha që zënë shpenzimet sipas llogarive ekonomike për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në vitin 2021.


**Grafiku 28: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik për vitet 2021**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Sipas funksioneve, gjatë vitit 2021, pushteti vendor ka financuar në pjesën më të madhe funksionin e “Shërbimeve të përgjithshme publike” dhe “Arsimit”, përkatësisht në masën 23.4% dhe 19.5% të totalit të shpenzimeve vendore. Përsa e këtyre shpenzimeve të pushtetit vendor sipas funksioneve paraqet qartë rëndësinë që kanë këto shpenzimeve në raport me shërbimet publike që njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë.

**Grafiku 29: Përsa e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas klasifikimit funksional për vitet 2021-2020.**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Gjatë vitit 2021, shpenzimet e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime në disa prej funksioneve bazë si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia dhe domosdoshmërisë për të ofruar disa shërbime bazë për qytetarët. Si rrjedhojë e përmirësimit të ecurisë së treguesve kosntatohet që të gjitha funksionet kanë patur rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2021 krahasuar me një vit më parë me përjashtim të funksionit “04-Çështjet ekonomike” i cili ka patur një rënie prej -2%.

Ndërkohë nga ana tjetër gjatë vitit 2021 funksionet me rritjen më të madhe krahasuar me vitin 2020 me rreth 9% e kanë pësuar ato të “05-Mbrojtja e Mjedisit” dhe “07-Shëndetësia”. Një ndryshim të rëndësishëm në rritje ka pësuar gjithashtu edhe funksionet e “10-Mbrojtja Sociale” dhe “08-Argëtimi, Kultura dhe Feja” me rreth 8% krahasuar me një vit më parë.

Analiza krahasimore e ndryshimit në vite të shpenzimeve sipas funksioneve është një aspekt i rëndësishëm i evidentimit të prioriteteve që njësitë e vetëqeverisjes vendore ndryshojnë nga vitit në vit në raport me shërbimet publike që ofrojnë.


**Grafiku 30: Ndryshimi i shpenzimeve në nivel funksioni 2021/2020.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Nëse do të marrim në analizë një aspekt të rëndësishëm të politikave vendore në menaxhimin e financave për financimin e funksioneve ligjore sipas burimeve të të ardhurave do të konstatojmë një shpërndarje si në grafikun e mëposhtëm. Nga të dhënat eidentohet që vetëm funksioni “Shërbime të Përgjithshme Publike” financohet në rreth 1 miliard lekë më shumë nga transfertat e buxhetit qendror. Ndërkohë nga të ardhurat e veta pushteti vendor financon më shumë funksionet e “Çështjeve ekonomike”, “Mbrojtja e mjedisit” apo funksioni “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”. Funksionet të cilat janë financuar kryesisht me transfertat që pushteti vendor merr nga ai qendror janë të tilla si “Shërbimet e Përgjithshme Publike”, “Rendi dhe siguria publike”, “Arsimi” dhe “Mbrojtja Sociale”.


**Grafiku 31: Pesha e shpenzimeve sipas funksioneve të pushtetit vendor gjatë vitit 2021.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Në grafikun e mëposhtem paraqitet ndryshimet e peshës së shpenzimeve sipas funksioneve dhe burimit të financimit të tyre në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Rënie më të madhe e kanë shpenzimet në funksionin e “Shëndetësisë” me burim financimi të ardhurat e veta të bashkive me rreth 23%, dhe pas saj funksioni i “Rendit dhe Sigurisë” me rënie nga po ky burim në rreth 14%. Ndërkohë rritjen më të madhe të peshës së financimit nga transfertat e buxhetit qendror për funksionet e “Mbrojtjes së Mjedisit” dhe “Shërbimet e Përgjithshme Publike” përkatësisht me një rritje 22% dhe 15%

**Grafiku 32: Ndryshimet e shpenzimeve sipas funksioneve dhe burimit të financimit në vitin 2021/2020.**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Analiza e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimeve është një aspekt i rëndësishëm që evidenton nivelin e varësisë së njësisë të vetëqeverisjes vendore ndaj transfertave të buxhetit qendror. Roli i transfertës së pakushtëzuar në financimin e veprimtarisë së pushtetit vendor është konstant ndër vite ashtu sic është përcaktuar në kapitullin e mësipërm të autonomisë vendore. Ashtu siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm, shpenzimet e pushtetit vendor sipas burimit gjatë vitit 2021 janë mbuluar pothuajse në

mënyrë të barabartë ndërmjet transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të veta vendore. Ky trend i burimit të financimit gjatë vitit 2021 nuk ka ndryshuar krahasuar me një vit më parë.


**Grafiku 33: Përbërja e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimit të financimit për vitin 2021-2020.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Nëse këtë tregues në nivel këmbëtar do ta analizojmë sipas njësive të vetëqeverisjes vendore mbi burimin e realizimit të shpenzimeve gjatë vitit 2021, treguesit do të paraqiten si në grafikun e mëposhtëm:

**Grafiku 34: Pesha e shpenzimeve të NJVQV-ve sipas burimit të financimit për vitin 2021-2020.**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Duke marrë në analizë ndryshimin në shpenzimet e pushtetit vendor nga vitit 2020 në vitin 2021 sipas njësive të vetëqeverisjes vendore konstatohen të dhënat si në grafikun e mëposhtëm. Duke qenë se nga viti 2020 në vitin 2021 ka vazhduar rimëkëmbja e ekonomisë pas ngjarjeve të jashtëzakonshme të këtyre dy viteve të fundit, kjo gjë reflektohet edhe në buxhetet individuale të bashkive. Vetëm 7 bashki nga totali kanë patur një rënie të shpenzimeve në vitin 2021 në raport me shpenzimet e realizuara në vitin 2020. Bashkitë me rënie më të madhe janë bashkitë Rrogozhinë me një rënie prej 23%, bashkia Skrapar me rreth 13% apo bashkia Tiranë me rreth 12% rënie të shpenzimeve. Nga ana tjetër, 54 bashki kanë patur të njëjtat shpenzime ose rritje të shpenzimeve në vitin 2021 në raport me vitin 2020. 8 bashki kanë patur rritje të shpenzimeve nga 0%-3%, 19 bashki kanë patur rritje nga 4%-10%, 14 bashki kanë patur rritje të shpenzimeve nga 11%-19% dhe 13 bashki kanë patur rritje mbi 20%. Bashkitë të cilat kanë patur rritjen më të madhe të shpenzimeve gjatë vitit 2021 janë bashkia Vorë me 66% apo bashkia Tropojë me 60% rritje në raport me vitin 2020.

Ndryshimi i shpenzimeve në rritje në shumicën e njësive të vetëqeverisjes vendore, ku përfshihen kryesisht bashkitë që zënë një peshë të madhe në totalin e shpenzimeve të pushtetit vendor janë një tregues i rëndësishëm i ecurisë pozitive ekonomike që kanë patur njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit buxhetor 2021. Konsolidimi i menaxhimit financiar publik në nivel vendor, duhet të reflektohet në të gjithë treguesit me qëllim ndikimin e drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve.

**Grafiku 35: Norma e ndryshimit të shpenzimeve të njëjive të vetëqeverisjes vendore 2021/2020**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

### 3.3 Detyrimet e prapambetura


Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2021, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është rreth **6.6 miliard lekë**. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth **0.7 miliard lekë** krahasuar me stokun e detyrimit në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, që ishte rreth **7.3 miliard lekë**; dhe është ulur me rreth **0.5 miliard lekë** krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2020, që ishte rreth **7.1 miliard lekë**.

Stokun më të lartë të detyrimeve vazhdon e ka **bashkia Kavajë** në vlerën rreth **820 milion lekë**, e cila përbën 12.7% të totalit të detyrimeve. Më pas, **bashkia Tiranë** në vlerën rreth **632 milion lekë**, e cila përbën 9.8% të totalit të detyrimeve; **bashkia Vorë** në vlerën rreth **516 milion lekë**, e cila përbën 8% të totalit të detyrimeve; **bashkia Malësi e Madhe** në vlerën rreth **323 milion lekë**, e cila përbën 5% të totalit të detyrimeve. Më pas renditen bashkia Pogradec dhe Durrës.

Ndërsa, sa i përket Këshillave të Qarqeve, stokun më të lartë të detyrimit e ka **Këshilli i Qarkut Durrës** në vlerën rreth **56 milion lekë**, e cila përbën 46.5% të totalit të detyrimeve; Këshilli i **Qarkut Berat** në vlerën rreth **47 milion lekë**, e cila përbën 39.2% të totalit të detyrimeve; Këshilli i **Qarkut Gjirokastrë** në vlerën rreth **15 milion lekë**, e cila përbën 12.8% të totalit të detyrimeve. Më pas renditen Këshilli i Qarkut Vlorë dhe Këshilli i Qarkut Korçë.

Sipas kategorive, për bashkitë peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë kategoria “Investime” me 55.9%, më pas, kategoria “Të tjera” 14.7%, “Shërbime” 11.1%, dhe “Vendime Gjyqësore” 8.9%. Ndërsa sa i përket qarqeve, stoku i detyrimit të tyre përbëhet kryesisht nga vendime gjyqësore, të cilat zënë 96.4% të totalit të detyrimit të qarqeve.

**Grafiku 36: Detyrimet sipas kategorive në përqindje, për bashkitë**



në lekë


Llog. Ekonomike	Kategoria	Bashki	Qarqe	Pesha ne % Bashki	Pesha ne % Qarqe
4864100	Vendime Gjyqesore	572,811,506	115,370,536	8.9%	96.4%
4864200	Det. Prap. Sherbime	719,064,162	1,448,121	11.1%	1.2%
4864300	Det. Prap. Mirembajtje	178,608,818	0	2.8%	0.0%
4864400	Det. Prap. Investime	3,612,949,903	739,225	55.9%	0.6%
4864500	Det. Prap. Rimbursi. TVSH	758,305	0	0.0%	0.0%
4864600	Mallra	345,941,812	705,546	5.4%	0.6%
4864900	Det. Prap. Te Tjera	953,102,787	1,435,940	14.7%	1.2%
4864601	Det. Prap. Sig. Shoqerore	48,318,652	0	0.7%	0.0%
4864602	Det. Prap. Sig. Shendet	4,098,637	0	0.1%	0.0%
4864603	Det. Prap. Ardh. Personal	21,671,419	0	0.3%	0.0%
4864604	Det. Prap. Tatime Tjera	6,329,522	0	0.1%	0.0%
	<b>TOTAL</b>	<b>6,463,655,523</b>	<b>119,699,368</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

**Analiza e treguesve  
fiskal sipas njësive të  
vetëqeverisjes vendore**

# Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas bashkive

## 152 Bashkia Belsh


Gjatë vitit 2021, bashkia Belsh, ka realizuar **76,937 mijë lekë** të ardhura të veta, ndër të cilat 65,935 mijë lekë, ose 85.7 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Belsh krahasuar me vitin 2020, janë rritur me 28.8%. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë: taksa mbi ndërtesën (-3%), taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-16%). Ndërkohë, taksa mbi tokën bujqësore është rritur në masën 2% krahasuar me vitin 2020, tarifa vendore për zënien e hapësirave publike është rritur në masën 408%, tarifa e pastrimit dhe higjienës me 1%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 54 % të totalit; taksa mbi tokën bujqësore, e cila përbën 34 % të totalit.



Në vitin 2021, bashkia Belsh me një popullsi prej 23,742 banorë ka realizuar në total **278,847 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë ulur me rreth 2 % ose rreth 6,141 mijë lekë, nga 284,988 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në *mijë lekë*:


Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	192,147	208,524	164,097	167,952	-16,377	-8%
Personeli	123, 849	145,399	115,129	123,102	-21,550	-15%
Operative	67,357	60,260	44,181	42,941	7,097	12%
Të tjera	941	2,865	4,787	1,909	-1,924	-67%
Shpenzime Kapitale	86,700	76,464	66,311	24,434	10,236	13%
TOTALI	278,847	284,988	230,408	192,386	-6,141	-2%

Për vitin 2021, bashkia Belsh ka kryer 11.7 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 8.1 mijë lekë shpenzime korente për banor dhe 3.6 mijë lekë shpenzime kapitale për banor. Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 44.4%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 24.2% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 0.3%, ndërsa ato për investime rreth 31.1%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme, transfertën e pakushtëzuar sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafiki i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2021 dhe 2020 paraqitet si më poshtë:



## 102 Bashkia Berat


Gjatë vitit 2021, bashkia Berat, ka realizuar **350,902 mijë lekë** të ardhura të veta, ndër të cilat 313,897 mijë lekë, ose 89.4 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Berat krahasuar me vitin 2020, janë rritur me 20.7 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 është vetëm taksa mbi tokën bujqësore (-8%). Ndërkohë, ndër taksat që paraqiten me rritje në viti 2021, krahasuar me vitin 2020, janë: taksa mbi ndërtesën 7%, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja 284%, tarifa vendore për zënien e hapësirave publike 27%, dhe tarifa e pastrimit dhe higjienës 11%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 34 % të totalit; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe taksa vendore e gjelbërt, të cilat përbëjnë 23 % të totalit.



Në vitin 2021, bashkia Berat me një popullsi prej 72,032 banorë ka realizuar në total **993,080 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 18% ose rreth 153,796 mijë lekë nga 839,284 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:


Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	823,941	728,015	658,495	705,378	95,926	13%
<i>Personeli</i>	487,533	465,890	479,791	467,723	21,643	5%
<i>Operative</i>	290,367	228,024	150,670	208,451	62,343	27%
<i>Të tjera</i>	46,041	34,101	28,033	29,204	11,940	35%
Shpenzime Kapitale	169,139	111,269	245,317	163,739	57,870	52%
TOTALI	993,080	839,284	903,812	869,117	153,796	18%

Për vitin 2021, bashkia Berat ka kryer 13.8 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 11.4 mijë lekë shpenzime korrente për banor dhe 2.3 mijë lekë shpenzime kapitale për banor. Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 49.1%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 29.2% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4.6%, ndërsa ato për investime rreth 17%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme, transfertën e pakushtëzuar sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2021 dhe 2020 paraqitet si më poshtë:



## 103 Bashkia Bulqizë


Gjatë vitit 2021, bashkia Bulqizë, ka realizuar **44,939 mijë lekë** të ardhura të veta, ndër të cilat 39,364 mijë lekë, ose 87.6 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Bulqizë krahasuar me vitin 2020, janë rritur me 4.9 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm, taksat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-58%), tarifa vendore për zënien e hapësirave publike (-100%), ndërkohë, taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 35%, taksa mbi tokën bujqësore është rritur në masën 4937%, tarifa e pastrimit dhe higjienës është rritur në masën 20%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 44 % të totalit; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 30 % të totalit.



Në vitin 2021, bashkia Bulqizë me një popullsi prej 33,914 banorë ka realizuar në total **480,472 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 3% ose rreth 15,176 mijë lekë nga 465,295 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:


Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	360,416	362,833	354,351	330,480	-2,417	-1%
<i>Personeli</i>	240,885	230,289	221,298	213,088	10,596	5%
<i>Operative</i>	109,530	118,643	130,762	107,393	-9,113	-8%
<i>Të tjera</i>	10,001	13,901	2,291	10,000	-3,900	-28%
Shpenzime Kapitale	120,056	102,463	221,589	95,486	17,593	17%
TOTALI	480,472	465,295	575,940	425,967	15,176	3%

Për vitin 2021, bashkia Bulqizë ka kryer 14.2 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 10.6 mijë lekë shpenzime korente për banor dhe 3.5 mijë lekë shpenzime kapitale për banor. Pesa që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 50.1%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 22.8% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 2.1%, ndërsa ato për investime rreth 25%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme, transfertën e pakushtëzuar sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafiku i raportit të ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2021 dhe 2020 jepet si më poshtë:



## 110 Bashkia Cërrik


Gjatë vitit 2021, bashkia Cërrik, ka realizuar **112,740 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 88,156 mijë lekë, ose 78.2 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Cërrik krahasuar me vitin 2020, janë rritur me 15.7 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-21%), tarifa vendore për zënien e hapësirave publike (-2%). Ndërkohë, taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 21 %, taksa mbi tokën bujqësore në masën 32%, dhe tarifa e pastrimit dhe higjienës në masën 39%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 45 % të totalit; taksa mbi tokën bujqësore e cila përbën 28 % të totalit.



Në vitin 2021, bashkia Cërrik me një popullsi prej 33,569 banorë ka realizuar në total **352,519 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 9% ose 29,908 mijë lekë nga 322,611 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:


Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
<b>Shpenzime Korrente</b>	286,165	256,323	260,670	236,905	29,842	<b>12%</b>
<i>Personeli</i>	189,698	166,873	184,582	164,627	22,825	14%
<i>Operative</i>	92,058	77,849	68,163	68,052	14,209	18%
<i>Të tjera</i>	4,409	11,601	7,925	4,226	-7,193	-62%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	66,353	66,287	88,850	44,675	66	0%
<b>TOTALI</b>	352,519	322,611	349,519	281,580	29,908	9%

Për vitin 2021, bashkia Cërrik ka kryer 10.5 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 8.5 mijë lekë shpenzime korente për banor dhe 2 mijë lekë shpenzime kapitale për banor. Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 53.8%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 26.1% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 1.3%, ndërsa ato për investime rreth 18.8%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme, transfertën e pakushtëzuar sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2021 dhe 2020 jepet si më poshtë:



## 104 Bashkia Delvinë


Gjatë vitit 2021, Delvinë, ka realizuar **29,496 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 20,404 mijë lekë, ose 69.2 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Delvinë krahasuar me vitin 2020, janë ulur me 13.5 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë: taksa mbi tokën bujqësore (-2%), taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-43%), tarifa vendore për zënien e hapësirave publike (-66%). Ndërkohë, taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 18%, tarifa e pastrimit dhe higjienës nuk ka ndryshuar. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi tokën bujqësore e cila përbën 49 % të totalit; taksa mbi ndërtesën, e cila përbën 27 % të totalit.



Në vitin 2021, bashkia Delvinë me një popullsi prej 10,907 banorë ka realizuar në total **183,194 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 13% ose 20,696 mijë lekë, nga 162,498 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:


Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	142,816	140,535	130,662	135,956	2,281	2%
<i>Personeli</i>	111,292	101,941	103,007	101,172	9,350	9%
<i>Operative</i>	30,693	38,246	27,434	34,298	-7,553	-20%
<i>Të tjera</i>	832	348	221	486	484	139%
Shpenzime Kapitale	40,378	21,963	32,894	43,812	18,415	84%
TOTALI	183,194	162,498	163,557	179,768	20,696	13%

Për vitin 2021, bashkia Delvinë ka kryer 16.8 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 13.1 mijë lekë shpenzime korente për banor dhe 3.7 mijë lekë shpenzime kapitale për banor. Peshë që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 60.8%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 16.8% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 0.5%, ndërsa ato për investime rreth 22%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme, transfertën e pakushtëzuar sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2021 dhe 2020 jepet si më poshtë:



## 105 Bashkia Devoll


Gjatë vitit 2021, bashkia Vau i Dejës ka realizuar **81,877 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 75,527 mijë lekë, ose 92.2 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të bashkisë Vau i Dejës janë rritur me 4.1 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 është taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-45%), ndërkohë taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 18%, taksa mbi tokën bujqësore në masën 7%, dhe tarifa e pastrimit dhe higjienës në masën 14%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: Taksa mbi ndërtesën e cila përbën 44 % të totalit; taksa mbi tokën bujqësore e cila përbën 27 % të totalit.



Në vitin 2021, bashkia Vau i Dejës me një popullsi prej 36,849 banorë ka realizuar në total **404,425 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë pothuajse në të njëjtin nivel nga 404,376 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Shpenzimet e personelit dhe ato operative kanë përkatësisht 7% rritje secili zë, ndërkohë që ulje vërehet në shpenzimet për investime dhe shpenzime të tjera korente. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:


Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	358,194	339,997	300,607	233,229	18,197	5%
Personeli	253,681	236,086	198,495	173,401	17,595	7%
Operative	93,719	87,382	85,060	54,217	6,337	7%
Të tjera	10,795	16,528	17,052	5,612	-5,734	-35%
Shpenzime Kapitale	46,231	64,379	346,311	80,147	-18,148	-28%
TOTALI	404,425	404,376	646,918	313,377	49	0%

Për vitin 2021, bashkia Vau i Dejës ka kryer 11.5 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 9.7 mijë lekë shpenzime korente për banor dhe 1.3 mijë lekë shpenzime kapitale për banor. Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 62.7%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 23.2% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 2.7%, ndërsa ato për investime rreth 11.4%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:



## 146 Bashkia Vlorë


Gjatë vitit 2021, bashkia Vlorë ka realizuar **881,646 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 749,285 mijë lekë, ose 85 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e bashkisë Vlorë janë rritur me 34.9 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 është vetëm taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-10%), ndërkohë taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 64%, taksa mbi tokën bujqësore në masën 3%, tarifa vendore për zënie e hapësirave publike në masën 206%, tarifa e pastrimit dhe higjienës në masën 73%, taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 42 % të totalit; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 40 % të totalit.



Në vitin 2021, bashkia Vlorë me një popullsi prej 134,216 banorë ka realizuar në total **1,718,888 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 4% ose 61,147 mijë lekë nga 1,657,740 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:


Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
<b>Shpenzime Korrente</b>	1,476,555	1,488,874	1,497,117	1,425,773	-12,319	<b>-1%</b>
<i>Personeli</i>	811,580	733,816	664,425	614,543	77,765	11%
<b>Operative</b>	594,420	688,917	770,128	779,149	-94,498	<b>-14%</b>
<i>Të tjera</i>	70,555	66,141	62,565	32,080	4,414	7%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	242,333	168,866	188,531	99,694	73,466	<b>44%</b>
<b>TOTALI</b>	1,718,888	1,657,740	1,685,648	1,525,468	61,147	<b>4%</b>

Për vitin 2021, bashkia Vlorë ka kryer 12.8 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 11 mijë lekë shpenzime korrente për banor dhe 1.8 mijë lekë shpenzime kapitale për banor. Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 47.2%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 34.6% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4.1%, ndërsa ato për investime rreth 14.1%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:



## 165 Bashkia Vorë


Gjatë vitit 2021, bashkia Vorë ka realizuar **263,259 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 255,310 mijë lekë, ose 97 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e bashkisë Vorë janë ulur me 5 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë: taksa mbi tokën bujqësore (-30%), taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-11%), tarifa e pastrimit dhe higjienës (-10%), ndërkohë taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 4%, dhe të ardhurat jotatimore në masën 29%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 58 % të totalit ; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 26 % të totalit.



Në vitin 2021, bashkia Vorë me një popullsi prej 29,735 banorë ka realizuar në total **569,491 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 66% ose 225,787 mijë lekë nga 343,703 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
<b>Shpenzime Korrente</b>	309,646	280,930	348,263	391,652	28,717	<b>10%</b>
<i>Personeli</i>	219,831	209,039	207,046	202,535	10,792	5%
<i>Operative</i>	69,828	57,391	98,333	145,604	12,437	22%
<i>Të tjera</i>	19,987	14,500	42,884	43,513	5,487	38%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	259,844	62,774	267,688	285,890	197,071	314%
<b>TOTALI</b>	569,491	343,703	615,951	677,541	225,787	66%

Për vitin 2021, bashkia Vorë ka kryer 19.2 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 10.4 mijë lekë shpenzime korente për banor dhe 8.7 mijë lekë shpenzime kapitale për banor. Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 38.6%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 12.3% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 3.5%, ndërsa ato për investime rreth 45.6%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:



# Analiza e buxheteve sipas Këshillave të Qarqeve në të ardhura dhe shpenzime


## 042 Këshilli i Qarkut Berat

Gjatë vitit 2021, Qarku Berat ka realizuar **370 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 1.5 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Berat në vendin e 4-t, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, totali i të ardhurave të mbledhura janë të ardhura jotatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Berat janë rritur me 90.2 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Berat ka realizuar në total **23,652 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë ulur me rreth 25% ose 7,879 mijë lekë nga 31,531 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	22,162	23,124	28,485	29,279	-962	-4%
<i>Personeli</i>	16,375	16,400	16,732	16,840	-24	0%
<i>Operative</i>	5,637	6,605	11,753	12,263	-968	-15%
<i>Të tjera</i>	150	119	0	177	31	26%
Shpenzime Kapitale	1,490	8,407	500	4,227	-6,916	-82%
TOTALI	23,652	31,531	28,984	33,506	-7,879	-25%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 69%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 24% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 0.6%, ndërsa ato për investime rreth 6.3%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 046 Këshilli i Qarkut Dibër

Gjatë vitit 2021, Qarku Dibër ka realizuar **186 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 0.7 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Dibër në vendin e 8-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 186 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Dibër janë ulur me 17 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Dibër ka realizuar në total **37,553 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 45% ose 11,639 mijë lekë nga 25,914 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	32,821	25,676	35,731	29,896	7,145	28%
<i>Personeli</i>	14,521	16,526	16,914	17,519	-2,005	-12%
<i>Operative</i>	6,342	6,943	7,687	8,128	-601	-9%
<i>Të tjera</i>	11,957	2,207	11,131	4,249	9,750	442%
Shpenzime Kapitale	4,733	239	12,982		4,494	1882%
TOTALI	37,553	25,914	48,713	29,896	11,639	45%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 39%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 17% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 32%, ndërsa ato për investime rreth 12.6%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafiku, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 047 Këshilli i Qarkut Durrës

Gjatë vitit 2021, Qarku Durrës ka realizuar **45 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 0.2 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Dibër në vendin e 12-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 45 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Durrës janë ulur me 88.7 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Durrës ka realizuar në total **110,171 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 70% ose 45,246 mijë lekë nga 64,925 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	27,353	28,926	32,304	30,047	-1,573	-5%
<i>Personeli</i>	15,556	16,182	15,723	15,375	-627	-4%
<i>Operative</i>	11,715	12,743	15,081	14,072	-1,028	-8%
<i>Të tjera</i>	82	0	1,500	600	82	
Shpenzime Kapitale	82,818	36,000	36,743	15,012	46,818	130%
TOTALI	110,171	64,925	69,047	45,060	45,246	70%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 14%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 10.6% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 0.1%, ndërsa ato për investime rreth 75%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 048 Këshilli i Qarkut Elbasan

Gjatë vitit 2021, Qarku Elbasan ka realizuar **1,296 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 5.1 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Elbasan në vendin e 2-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 687 mijë lekë, ose 53 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Elbasan janë ulur me 50.7 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Elbasan ka realizuar në total **80,654 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë ulur me rreth 2% ose 1,437 mijë lekë nga 82,091 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Për këtë qark vërehet ulje e shpenzimeve të tjera korente dhe rritje e shpenzimeve kapitale. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	27,005	52,041	58,286	46,208	-25,036	-48%
Personeli	16,336	16,292	15,622	15,069	44	0%
Operative	7,272	5,320	7,287	9,778	1,952	37%
Të tjera	3,397	30,429	35,377	21,362	-27,032	-89%
Shpenzime Kapitale	53,649	30,050	26,889	23,208	23,599	79%
TOTALI	80,654	82,091	85,175	69,416	-1,437	-2%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 20%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 9% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4%, ndërsa ato për investime rreth 66.5%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafiku, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 049 Këshilli i Qarkut Fier

Gjatë vitit 2021, Qarku Fier ka realizuar **107 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 0.4 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Fier në vendin e 10-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 100 % e tyre janë të ardhura jotatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Fier janë rritur me 2 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Fier ka realizuar në total **53,799 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 51% ose 18,241 mijë lekë nga 35,558 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Për këtë qark vërehet rritje e shpenzimeve kapitale me më shumë se 200%. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	27,881	26,986	29,150	28,348	895	3%
Personeli	16,287	15,772	16,390	15,942	515	3%
Operative	11,543	11,213	12,306	12,279	330	3%
Të tjera	50	0	453	127	50	
Shpenzime Kapitale	25,918	8,572	119	2,884	17,346	202%
TOTALI	53,799	35,558	29,269	31,232	18,241	51%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 30%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 22% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 0.1%, ndërsa ato për investime rreth 48%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 011 Këshilli i Qarkut Gjirokastrë

Gjatë vitit 2021, Qarku Gjirokastrë ka realizuar **177 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 0.7 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Gjirokastrë në vendin e 9-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 177 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Gjirokastrë janë ulur me 49.1 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka realizuar në total **37,594 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 12% ose 4,112 mijë lekë nga 33,482 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
<b>Shpenzime Korrente</b>	29,366	26,848	28,283	29,282	2,517	9%
Personeli	15,590	16,049	16,069	15,697	-460	-3%
Operative	7,718	10,289	11,694	12,844	-2,571	-25%
Të tjera	6,058	510	520	741	5,548	1088%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	8,229	6,634	16,455	9,867	1,594	24%
<b>TOTALI</b>	37,594	33,482	44,738	39,148	4,112	12%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 41.5%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 20.5% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 16%, ndërsa ato për investime rreth 22%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 015 Këshilli i Qarkut Korçë

Gjatë vitit 2021, Qarku Korçë ka realizuar **358 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 1.4 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Korçë në vendin e 5-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 358 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Korçë janë rritur me 5.8 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Korçë ka realizuar në total **80,298 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë pothuajse në të njëjtin nivel pasi janë rritur vetëm me rreth 1% ose 475 mijë lekë nga 79,823 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	31,841	29,729	34,727	35,163	2,112	7%
Personeli	15,305	15,322	14,984	16,864	-17	0%
Operative	13,992	9,301	15,103	14,963	4,691	50%
Të tjera	2,544	5,106	4,640	3,336	-2,562	-50%
Shpenzime Kapitale	48,458	50,094	26,031	716	-1,637	-3%
TOTALI	80,298	79,823	60,757	35,879	475	1%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 19%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 17.4% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 3.2%, ndërsa ato për investime rreth 60%, që përfaqësojnë një nivel shumë të lartë investimesh në përqindje krahasuar me njësitë e tjera vendore. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 018 Këshilli i Qarkut Kukës

Gjatë vitit 2021, Qarku Kukës ka realizuar **283 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 1.1 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Kukës në vendin e 6-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 219 mijë lekë, ose 77.3 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Kukës rritur me 3.1 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Kukës ka realizuar në total **30,527 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 19% ose 4,855 mijë lekë nga 25,673 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	21,266	25,673	34,699	44,661	-4,407	-17%
Personeli	14,985	15,880	15,761	15,460	-895	-6%
Operative	5,149	8,693	12,439	24,718	-3,544	-41%
Të tjera	1,132	1,100	6,500	4,482	32	3%
Shpenzime Kapitale	9,261	0	6,145	79	9,261	
TOTALI	30,527	25,673	40,845	44,740	4,855	19%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 49%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 17% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 3.7%, ndërsa ato për investime rreth 30.3%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 020 Këshilli i Qarkut Lezhë

Gjatë vitit 2021, Qarku Lezhë ka realizuar **21,850 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 86.2 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Lezhë në vendin e 1-rë, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave Në realizimin e të ardhurave, 20,605 mijë lekë, ose 94.3 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Lezhë janë rritur me 213.5 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Lezhë ka realizuar në total **39,986 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë ulur me rreth 14% ose 6,588 mijë lekë nga 46,574 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	31,188	34,115	33,456	32,592	-2,927	-9%
Personeli	18,435	19,720	22,300	21,669	-1,285	-7%
Operative	10,904	13,495	6,106	5,774	-2,591	-19%
Të tjera	1,849	900	5,050	5,150	949	105%
Shpenzime Kapitale	8,798	12,459	60	465	-3,660	-29%
TOTALI	39,986	46,574	33,516	33,057	-6,588	-14%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 46%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 27% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4.6%, ndërsa ato për investime rreth 22%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




### 033 Këshilli i Qarkut Shkodër

Gjatë vitit 2021, Qarku Shkodër ka realizuar **92 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 0.3 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Shkodër në vendin e 11-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 92 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Shkodër janë ulur me 89.8 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Shkodër ka realizuar në total **27,986 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë ulur me rreth 26% ose 10,017 mijë lekë nga 38,004 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	23,085	24,276	24,495	37,372	-1,191	-5%
Personeli	15,866	15,846	15,647	15,443	20	0%
Operative	6,049	7,174	6,958	9,431	-1,126	-16%
Të tjera	1,170	1,256	1,890	12,497	-86	-7%
Shpenzime Kapitale	4,902	13,728	55,193	58,627	-8,826	-64%
TOTALI	27,986	38,004	79,688	95,999	-10,017	-26%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 57%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 22% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4.2%, ndërsa ato për investime rreth 17.5%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafikisht, raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 035 Këshilli i Qarkut Tiranë

Gjatë vitit 2021, Qarku Tiranë ka realizuar **189 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 0.7 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Tiranë në vendin e 7-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 189 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Tiranë janë ulur me 30.7 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Tiranë ka realizuar në total **95,883 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë ulur me rreth 7% ose 7,580 mijë lekë nga 103,463 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime Korrente	29,383	29,454	31,588	31,439	-71	0%
Personeli	15,957	15,604	15,441	15,812	353	2%
Operative	10,602	10,624	10,501	10,088	-22	0%
Të tjera	2,824	3,227	5,646	5,539	-403	-12%
Shpenzime Kapitale	66,499	74,008	87,427	33,098	-7,509	-10%
TOTALI	95,883	103,463	119,015	64,538	-7,580	-7%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 16.6%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 11% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 3%, ndërsa ato për investime rreth 69.4% që përfaqësojnë një nivel shumë të lartë investimesh në përqindje krahasuar me njësitë e tjera vendore. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafiki i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:




## 037 Këshilli i Qarkut Vlorë

Gjatë vitit 2021, Qarku Vlorë ka realizuar **402 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 1.6 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Vlorë në vendin e 3-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 402 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e vitit 2021 të Qarkut Vlorë janë ulur me 18.2 %.

Në vitin 2021, Këshilli i Qarkut Vlorë ka realizuar në total **55,413 mijë lekë shpenzime**. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë ulur me rreth 20% ose 14,279 mijë lekë nga 69,691 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë:

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
<b>Shpenzime Korrente</b>	31,417	26,811	25,546	34,703	4,607	17%
Personeli	16,441	16,113	17,030	16,883	328	2%
Operative	4,890	7,084	5,958	6,302	-2,194	-31%
Të tjera	10,086	3,614	2,558	11,518	6,472	179%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	23,995	42,880	11,137	1,693	-18,885	-44%
<b>TOTALI</b>	55,413	69,691	36,683	36,396	-14,279	-20%

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2021 është rreth 30%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 9% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 18%, ndërsa ato për investime rreth 43.3% që përfaqësojnë një nivel shumë të lartë investimesh në përqindje krahasuar me njësitë e tjera vendore. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Grafiki i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:



\* Në llogaritjen e të ardhurave të veta nuk janë përfshirë të ardhurat që klasifikohen si grante nga buxheti i pushtetit qendror ose vendor.



**Sfidat e realizimit të buxhetit  
vendor në vitin 2021**

**M**enxhimi Financiar Publik në vitet e fundit është përballur me sfida të vazhdueshme të cilat kanë testuar qëndrueshmërinë, eficiencën dhe rolin shumë të rëndësishëm të pushteti vendor në shërbimet publike dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2021 ka punuar në drejtim të përmirësimit të procesve të menaxhimit financiar në nivel vendor të tilla si:

- **Buxhetimi në nivel produkti**, është një ndër objektivat e rëndësishme përmes së cilit synohet që njësitë e vetëqeverisjes vendore të kostojnë produktet e shërbimeve që ofrojnë për qytetarët. Në udhëzimin vjetor të programit buxhetor afatmesëm, u shtua konceptimi i buxhetimit të njërive të vetëqeverisjes vendore në nivel produkti, me qëllim lidhje e të gjitha shpenzimeve me produkte me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Kalimi në një koncept më të detajuar buxhetimi, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ishte një sfidë e cila u shoqërua me trajnime, takime dhe diskutime me të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në drejtim të buxhetimit për çdo program në nivel produkti. Në PBA 2022-2024, disa bashki kanë planifikuar në nivel produkti dhe pjesa tjetër kanë përparuar në drejtim të përfshirjes në këtë proces. Për PBA 2023-2025 po punohet me projektin “Financat Lokale” për të konsoliduar buxhetimin në nivel produkti tek të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- **Realizimi i treguesve fiskalë**, pas një paqëndrueshmërie të treguesve fiskalë të vitit 2020 pritshmëritë për rimëkëmbjen ekonomike ku përfshihet edhe pushteti vendor ishin të larta. Në këtë kuptim Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka ndjekur periodikisht në 4 mujorin, 6 mujorin dhe 9 mujorin e realizimit të treguesve fiskalë të pushteti vendor në drejtim të konsolidimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor. Ashtu sic mund të evidentohet në treguesit e këtij raporti, të ardhurat vendore janë rikuperuar me një ritëm shumeë më të shpejtë se sa pritshmëritë për realizimin e shpenzimeve. Si rrjedhohë, sfidë e rëndësishme ishte kthimi në normalitet i treguesve dhe ruajtja e qëndrueshmërisë së të ardhurave vendore që reflektohen drejtpërdrejt në shërbime publike.
- **Shpërndarja periodike e Tatimit mbi të Ardhurat Personale**, tashmë është realizuar në përputhje më përcaktimet dhe kërkesat e ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore. Ndërtimi i një metodologjie dhe shpërndarje TAP në përputhje me përcaktimet ligjore u konsolidua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2021. Njësitë e vetëqeverisjes vendore tashmë kanë një burim të rëndësishëm

të të ardhurave, për ta vendosur në funksion të financimit të shërbimeve publikë. Gjatë vitit 2021 janë shpërndarë rreth 794.6 milion lekë million lekë të ardhura nga ky burim,.

- **Financimi i funksioneve** në përputhje me strategjinë e decentralizimit dhe ndjekja e ecurisë së mbulimit me shërbime të pushtetit vendorë kanë mbetur një sfidë për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Hartimi i metodologjive për monitorimin e ecurisë së zbatimit të funksioneve mbi bazën e treguesve buxhetorë dhe matja e cilësisë së shërbimeve mbi produktet e planifikuara në programin buxhetor afatmesëm, janë synime të rëndësishme në funksion të përmirësimit të ecurisë së shërbimeve vendore. Lidhja e financimit të shërbimeve me produkte buxhetore të matshme, do të jetë synimi nga i cili evidentohet qartë rëndësia e menaxhimit financiar publik mbi bazë performace.
- **Ulja e detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimi i gjendjes financiare** të njësive të vetëqeverisjes vendore në periudhë afatgjatë është një ndër sfidat strategjike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në drejtim të menaxhimit financiar në nivel vendor. Gjatë vitit 2021, janë realizuar vlerësime dhe raportime periodike mbi ecurinë financiare të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore. Mbështetur mbi treguesit fiskalë gjithashtu janë dhënë rekomandime ndaj njësive të cilat kanë një ecuri jo pozitive në drejtim të rritjes së stokut të detyrimeve ndaj të tretëve. Ky proces monitorimi do të vazhdojë periodisht gjithashtu edhe në vitin 2022, duke zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.



**Përfundime dhe Rekomandime**

**D**uke u mbështetur mbi treguesit pozitivë të ecurisë së decentralizimit fiskal dhe rritjes së cilësisë së Menaxhimit Financiar Publik në nivel vendor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjatë vitit 2021 ka ndjekur me prioritet thellimin e reformave në nivel vendor. Gjatë vitit 2022, synohet të ruhen ngushtësisht treguesit pozitiv të rritjes së rolit të pushtetit vendor në forcimin e kapacitetit fiskal por gjithashtu edhe në rëndësinë e shërbimeve publike. Ruajtja e trendit pozitiv të ecurisë së konsolidimit financiar në nivel vendor dhe zbatimi i plotë të njësitë të vetëqeverisjes vendore i të gjitha metodologjive të hartuara janë tregues të rëndësishëm për ecurinë e punës së MFE. Në këtë këndvështrim, disa nga konstatimet që dalin nga raporti i treguesve të realizimit të buxhetit vendor 2021 janë si më poshtë:

- Rritja e kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore përmes rritjes së peshës së të ardhurave të veta vendore në buxhetin vendor.

Rritja e të ardhurave të veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, si tregues i kapacitetit fiskal është e rëndësishme për konsolidimin financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore. Thellimi në analizën e kapacitetit sipas njësive të vetëqeverisjes vendore është thelbësor për tu zhvilluar gjatë vitit 2022, me qëllim për të identifikuar kapacitetet e decentralizimit aktual fiskal dhe evidentimin e mundësive të reja në kuadër të këtij procesi.

- Ruajtja e niveleve të të ardhurave të veta vendore.

Një ndër treguesit më të rëndësishëm të konsolidimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore do të jetë rritja e aftësive të tyre për të siguruar të ardhura nga burimet e veta dhe arkëtimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme në kohë. Gjatë vitit 2021, pushteti vendor siguroi një rritje sinjifikative të të ardhurave në raport me planin, tregues ky i kapacitetit në rritje të njësive për të siguruar qëndrueshmërinë e financimit të funksioneve. Në këtë drejtim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të ndjekë me prioritet ruajtjen e qëndrueshmërisë së rritjes së të ardhurave vendore.

- Ruajtja e trendeve të njëjta të realizimit të shpenzimeve të pushtetit vendor në muaj

Në kuadër të mirëmenaxhimit financiar në nivel vendor me qëllim për të shmangur trendin e relizimit shumë të madh të shpenzimeve në fund të vitit, kryesisht shpenzimeve për investime, është i nevojshëm rekomandimi për realizimin e shpenzimeve nën një plan të detajuar mujor i cili mundëson disiplinën e shpenzimeve dhe shmangien e mundësisë për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

- Zhvillimi ekonomik lokal dhe ulja e pabarazive midis njësive të vetëqeverisjes vendore.

Duke ju referuar kreut të treguesve të autonomisë vendore evidentohen qartë diferencat ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore në treguesit fiskalë vjetor. Përmes politikave të reja të menaxhimit financiar, do të synohet ulja e diferencave dhe sigurimi i një financimi të qëndrueshëm në nivel vendor. Pushteti vendor si pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik kombëtar ka në thelb nxitjen e politikave të zhvillimit rajonal. Një ekonomi e fortë lokale në nivel njësie do të përkthehet në një ekonomi të qëndrueshme kombetare dhe sigurisht mirëqenie me të lartë për qytetarët. Instrumentet financiarë të vetëqeverisjes vendore duhet të orientohen në funksion të zhvillimit ekonomik dhe uljen e pabarazive midis njësive në funksion të zhvillimit kombëtar.

- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin.

Një sfidë e rëndësishme për tu thelluar në qeverisjen vendore mbetet rritja e transparencës dhe llogaridhënjes përmes pjesëmarrjes qytetare në proceset e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm. Një pushtet vendor i konsoliduar do të thotë një transparencë më e madhe në lidhje me punën e zhvilluar për arritjen e objektivave. Në këto kushte, gjatë vitit 2022 e në vazhdim Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të synojë nxitjen e njësive të vetëqeverisjes vendore në ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e transparencës përmes publikimit dhe hartimit të buxhetit të qytetarit.

- Implementimi i AFMIS në nivel vendor.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të nisë një proces të rëndësishëm të shtrirjes së Albanian Financial Management Information System (AFMIS) në nivel vendor. Nga ky proces do të synohet përfshirja e të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore në sistemin e menaxhimit financiar, përmes së cilës do të unifikohet procesi i planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit në nivel vendor.

- Forcimi i rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale në menaxhimin e vështirësive financiare.

Miratimi i Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” është një hap shumë i madh i cili i dha frymë procesit të krjimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin financiar publik në nivel vendor dhe menaxhimit të vështirësive financiare. Në këto kushte, janë hartuar të gjithë udhëzimet standarte që përmbyllin plotësisht kuadrin procedural dhe rregullativ të financave në nivel vendor. Duke ndjekur trendin e viteve të pas reformës administrative territoriale, gjatë vitit 2022 do të synohet rritja e kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe gjithashtu përmirësimi i shërbimeve publike të ofruara për qytetarët. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në mënyrë të vazhdueshme do të ndjekë e monitorojë procesin e menaxhimit financiar në nivel vendor dhe përmes tij vlerësimin e treguesve të performancës së NJVQV-ve. Në këtë kuptim, ky raport do të vijohet nga raporte të tjerë zyrtarë periodike në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe pjesëmarrjes së të gjitha grupeve të interesit në procesin e administrimit financiar vendor por gjithashtu ajo që është më e rëndësishmja pjesëmarrja qytetare në këtë proces.







Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zvicëran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

**FINANCATLOKALE** | Forcimi i Menaxhimit  
**LOCALFINANCES** | të Financave Publike  
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Sekretariati Zvicëran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO**